ВКЭН

BKSH

A. ZACO (ÇAJUP)

# Burr'i Dheut

## Tragjedi me vjersha

E NDARË NDË 5 PAMJE

BOTUAR NË SOFOKLI ÇAPI

KAIRO 1937.

BKSH

A. ZACO (ÇAJUP)

# Burr'i Dheut

## Tragjedi me vjersha

E NDARË NDË 5 PAMJE

BOTUAR PRE SOFOKLI ÇAPI

KAIRO 1937.

BKSH

G. KASTRIOTI (Skënder Beu)

BKSH

GJON KASTRIOTI me mbretëreshën përcjellën të katër djemtë e tyre në Endrene te Sulltan Murati.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË TIRANË



BKSH

G. KASTRIOTI (Skënder Beu)

# Këndonjësit.

Eshtë pun'e ditur që nga të têrë djemt e Janit Kastriotit, ay m'i vogëli shpëtoi nga vdekja.

Qysh shpëtoi Skënder-beu nga thonjt'e Sultanit ?

Kjo veprë na jep një përgjigje, na rrëfen një menyrë. Janë të vërteta ? Kush e di !...

Istoria na tregon punëtë që kanë gjarë vërtet. Per një tragodi, punëtë që mund të gjajnë janë mjaft, si na thotë vetë Aristoteli. E di fort mirë që i bir'i Muratit II, quej Muhamet po un'e quajta Selim dhe Muhametin e tregoj për të vëllan'e Sultan Muratit se ky kêmbim m'u duk i nevojshim për fillin (trama) e tragodisë.

Për të fortësuar ndjenjat kombëtare dhe dashurinë ndermjet t'onë, për të ndarë fenë nga kombësia, për të përhapur Shqipen që ka mbetur kaqë pas, për të gatitur, me një fjalë, udhën e Lirisë, të tilla vepra kanë si-do-mos, një dobi, një rëndesi. Si thashë dhe kur botova "Baba-Tomorë" ç'do Shqipëtar duet të punojë për këtë qêllim të shenjtëruar.

Me këto vjersha desha të tregoj karakterin, besën, trimërinë dhe dëshirat e Shqipëtarëve të vërtetë.

Fiuid'i fjalës : J lutem Zotit të kujtojë sot Shqipërinë dhe ti dërgojë një Skënder-bej të dytë, që ta shpëtojë nga zgjedha dhe nga robëria.

Ndë Kairo, Mars 1908

Shkronjëtori A. Z. ÇHAJUPI

# VETAT

Murat' II ..— Sultan'i Turqisë.

Selimi.....— Shkon për i bir'i Muratit, po êsht vërtet Skënder-beu.

Mamica....— Motr'e Skënder-beut dhe bij'e Janit Kastriotit.

Fatimea ...— Shqipëtarkë dhe grua e dyt'e Sultanit Murat.

Musa.....— Vezir, i bir'i Fatimesë dhe i dashur i Mamicës.

Zadea .....— Motr'e Musá vezirit, e dashur'e Selimit.

Muhameti..— Vëlla'i Sultan Muratit.

Feriti.....— Pasha Turk, krye-spiun i Muratit.

Tahiri .....— Pasha Shqipëtar, krye-trim i Muratit.

Trima, mbronjës, ushtarë.

Nd' Endrene, mbrênda në pallat të Sultanit.

BKSH

BKSH

BKSH

## Pamj'e II

## *MURATI. FERITI.*

MURATI

Ç'kërkon sot prapë nga unë ?

FERITI

O Zot, ndëgjova një fjalë :
Kastrioti paska djalë,
Shqipëtarët u-trazuan,
Këtë djalë mbret e duan
Dhe ndë qytet, Shqipëtarët
E kërkojnë sot.....

MURATI

Të marët !
Nukë dinë këta derra,
Se Kastriotin e thera,
Bashkë me fis e me farë ?
Pse nuk'u zbulojnë varrë ?
Sot s'u gjëndet as një ashtë
Ianë bërë hi dhe kashtë ....
Në duan mbret të vërtetë,
T'a kërkojnë nd'atë jetë.
Po qysh e quajnë vallë
Ferit këtë princ të gjallë?

FERITI

Skënder - beu Kastrioti.

MURATI

Ha ! ha ! i maroftë Zoti !
Në mos kanë një mbret tjatër
Nukë trëmbem : Që të katrë
Djemt'e Janit janë tretur,
Sot as një nukë ka mbetur.
Skënder e vogël të gjorë
E thera vetë me dorë;
I dolli, kur ra ndë prak,
Më tepër qumësht se gjak;
Ndëgjo Ferit si ka gjarë ;
Dhe sot më vjen për të qarë;
Atë ditë nga një koqe,
Vdiq Sevdaja, ime shoqe,
Lehonë : nga hidhërimi,
Nga lotë që dirth Selimi,
Selim i bir'i Sevdasë,
Më vinte që të pëlcasë.,
Në këtë të madhe gjëmë
Që mbet Selimi pa mëmë,
Ca Shqipëtarë spiunë
Ryën ndë pallas këtunë
Edhe nga thonjt'e Turqisë
Muar princn'e Shqipërisë.
Të mos ish ndodhur një mike
Shqipëtarkë, po besnike,
(Që kish marë djalin tim
T'a rritij kur mbet jetim,)
Skënder - beu me një fjalë,
Dot'ishte vërtet i gjalë.
Fatimea vet'e zuri,
Këtu të gjallë m'a pruri.
Dojë t'a lërë të gjallë

Po, pa ngritur Shqipëria
Më këmbë për këtë punë
Ndëgjo zot, ç'mëjtim kam unë :
Kastrioti kur u shua
Më far'e fis e me sua,
Në mos mbeti as një djalë,
Çup'ë tij giëndët ë gjallë,
Zonja Mamica, kjo zonjë,
Vet' urdhrovë që të rrojë!....

MURATI

Dërgova, Ferit, e-zunë;
Katër vjet që rri këtunë,
Për hatër të Fatimesë
Dhashë fjalë, dhashë besë,
Çup e Janit të mos vritet,
Po si princesë të rritet,
Se Fatimea më thotë :
Mamica duet ndë botë
Të martonet me Selimnë.

FERITI

Ja pëlqej shunë mendimnë,
Ndëgjo dhe fjalët e mia :
Pa marrë zjar Shqipëria,
Me Mamicen e bekuar
Selimi duet martuar.
Shqipetarët kanë shpresë
Të madhe te kjo princesë
Dhe burri që dotë marrë
Esht' mbet për Shqipëtarë,
Dhe mukë dotë kërkojnë
Të ngjallin ata që s'rrojnë
Dot' harrojnë Skënder-benë
Motrën e-ti kur të kenë
Ndë Shqipëri mbretëreshë.

MURATI

Unë këtë qëllim keshë.
Po Ferit, zoti të faltë,
Dhe fjala jashtë mos daltë
Unë për Selimnë dua
Të jetë Sultan pas mua,
Sultan i gjithë Turqisë
Jo një princ i Shqipërisë
Me triměri që rrëfeu
Selimi, muk e nxê dheu :
Zotoi vênde të gjerë,
Serbin e shumë të tjerë.
Ferit, Selimi në rroftë,
Pas mua në mbretëroftë
Dotë madhojë Turqinë.

FERITI

Kjo punë s'bênet tanimë
Se ndë dorë nuk e kemi,
Pas zakonevet qe vemi,
Dhe nukë bën dot Sultani
Një gjê që s'e do Kurani,
Si do q'është trim e burrë
Selimi s'mbretëron kurrë :
Mohameti po të rrojë
Pas ty dotë mbretërojë.

MURATI

Ferit, si-do që të thonë
Po të dua prish zakonë

MURATI

O Ferit, po në mos dashtë ?

FERITI

Gratë, zot janë si kashtë :
Ven e vinë nga fryn era
Kemi parë dhe të tjera.
Pastaj kur s'shkon urtësia
Mbaron punë marëzia :
Foli me të keq një çikë
Se gratë binden me frikë.

MURATI

Ja ku vjen e do-të shomë

## Pamj'e III

## MURATI, FERITI, MAMICA

MURATI

Zonjë, ngre syt'e shukomë.
mos u sill si grat'e marra.

FERITI

Se ke një Sultan përpara.

MURATI

Ndëgjo mirë se ç'të themi,
Të duamë gjithë ç jemi,
Sultana një Shqipëtarkë,
Të mban për drek'e për darkë,
Dhe unë, ti e-di vetë
Të nderoj me të vërtetë,
Të mirat që të kâm bërë
I-di zonjë, bot'e tërë.
Të dua si t'ime bijë,
Prandaj rëndë mos të vijë
N'u zotua Shqipëria,
Ashtu deshi Perëndia.
Se po të duante Zoti
Dotë rronte Kastrioti.
Tani nder'i Shqipërisë
Dhe madhëri e Turqisë
Një punë nga ti kërkojnë
Dhe mir e ndë paq të rrojnë
Duetë, ti, dhe Selimi
Q'u rrëfye kagë trimi
Me luftëra që ka bërë
Q'e lëvdon një bot'e tërë,
Duetë them të bashkoni
Dhe që sonte të martoni.
Të kam dashur si një pjellë,
Shumë ligësht më je sjellë
Po shumë dotë të dua
Zonjë po të ndegjosh mua
Ndryshe dot qash me lot
Se me mua s'e nxjer dot.

MAMICA

O Sultan, mos më trëmb-mua
Se nuk jam si çdo grua,
Ti e di mirë se ç'jeshë
Dhe ç'jâm : bijë mbretëreshë.
Unë me fuqi të Zotit

Jam e bij'e Kastriotit,
E ati trimit që vare,
Mos harro, jam Shqipëtare ! :
Zot i math ma bie mbarë
Dhe ta vras, si e-ke vrarë.
Po ç mund të të bëj e mjera,
Kur s'mund te dal dot nga dera,
Kur jam mbylltur ndë pallas
Si një zok ndë një kafas !
Po ndëgjo Sultan Murati :
Kastrioti ç faj të pati,
Që vrave me të pa besë
Katrë djemt'e vetë pesë ?
Ay të dha miqësinë
Ashtu si kërkove tinë
Dhe djemtë peng t'i dergoi
Fat-ziu se të besoi.
Jo, Sultan jo ! Shqipëria
Nuk u prish nga Perëndia,
Se perëndia kam shpresë,
Nukë do njéri pa besë.
Me ç'ke bërë ti për mua
Qaej se nukë të dua
Dhe çuditej, egërcirë
Se nukë të sillem mirë ?
Qaej si-kur s'e-di shkaknë :
Gjaku, Sultan, kërkon gjaknë !
Kur s'ka princër Shqipëtarë
Për mua mbeti kjo barrë ;
Zot, n'ësht' e-rëndë për mua,
Mê prahir të vdes ; ç'e dua,
Ç'e dua, Zot, jetën ti'me ?
Kur jam e shkretë, jetime ?
Zot ç'e dua këtë jetë,
Kur s'mund të marr gjaknë vetë?
Kur sho vëndë tek kam lerë
Të zotuar nga të tjerë !
Kur sho armikn'e shtepisë
Q'është mbret'i Shqipërisë !
Kur sho atê që ka vrarë
T'im at me fis e me farë
Kur e sho ndë këtë jetë
Të kënaqur e të qetë !
Kur e ndëgjoj të më thotë
Që ska tjatër mbret ndë botë !
Gëzonem, Sultan Muratli,
Se sho që të zu inati
Për një grua Shqipëtare
Që nukë të peshon fare
Edhe të shtyn duke sharë
T'a vraç një ditë më parë
Se do të vdesë më mirë
Se të shojë nj'egërsirë.
Më le, duketë të gjallë
Që të më martosh me djalë
Edhe për nder të krushqisë
Më fal fron'e Shqipërisë !
Po këtë m'a fali Zoti
Dhe im'at Jan Kastrioti.
S'ësht' jotja Shqipëria
Jo ! e gjeç nga Perëndia
Dhe fron'e saj nuk e dua
Me gjak nga duart'e tua.
Ay që do të më marrë

Të lajë gjaknë mê parë.....
Sa për Selimnë të qoftë
Eshtë djal'i yt të rroftë;
Murât, të birrë tênd kurrë,
Mamica s'e do për burrë,
Se s'do të të bêjë vjerr
Se nukë të bën dot nder;
Bijë mbreti Shqipëtare
Mamica s'të peshon fare.

MURATI

Me këto fjalë që thua,
Si kur të mos jeshe grua
Dotë më zinte inati,
Dotë shoje ç bên Murati.
Me gjithë ç fole për mua
Unë përsëri të dua.
Më vjen keq se gjithë ç-bêra
Për ty vanë, dêm të têra;
Më vjen keq se po të doje
Tani ndryshe do të rroje;
Dotë keshe kupëtuar
Sa mirë të kam qëndruar.
Të dua si t'ime bijë
Mamica, keq të të vijë,
Për veten tënde mëparë
Ti kuvëndon si e marrë:
Të lashë thuaj të gjallë
Të të marr nuse për djalë
Që të më çtonet fuqia
Ndë vênd t'ënd: Po Shqipëria
Shqipëria jote trime
Eshtë sot ndë dorë time.
Atje për ty s'ka nevojë
Selimi të mbretërojë.
Sot Shqipëtarët më duan
Sa dhe besën e ndëruan;
Mysylmanë që të têrë
Sot pak janë të Krishtërë;
Shqiqëtarët Mysylmanë
Mbret'e Pejkamber me kanë
Dhe përgjëronen për mua;
Me këto fjalë që thua
Ti nuk'i di Shqipëtarët,
Nuk janë si të parët
Që vriteshin për Lirinë;
Sot janë ndënë Turqinë,
Kanë zakone të tjera,
Duan nishane, rytbera;
Vetëm një trimëri kanë
Të vritenë për Sultanë,
Vetëm një përçblim kërkojnë:
T'i mburrin e ti lëvdojnë
Dhe s'kanë tjatër deshirë
Janë shumë zêmër mirë
Dhe punojnë për të tjerë .....
Nukë janë si një herë:
Liri s'dinë ç do me thënë
Këto ndjenja i përzënë
Se s'e duan Shqipërinë
Po lëftojnë për Turqinë.
Janë kaqë trima, burra
Sa su bên para lëkura
Dhe vriten me njeri jetrë

Sot, sër një gunë të vjetrë
Shqipëria u ndërrua,
Nga faq'e dheut u shua;
Sot viset e Shqipërisë
Janë një cop'e Turqisë
Ata njers që më nderojnë
Këtu si duan punojnë:
Vrasën, presën, han'e pinë
Se kanë ndimë Turqinë
Nonjë prej ta, kur ngre kokë
Me pak a me shumë shokë
Sot s'mënojmë ta qërojmë
Me të fala q'u dërgojmë .....
Këtu mbretëroj pa frikë
Se janë burra besnikë.
Prandaj trimat që kam pranë
Gjithë Shqipëtarë janë
S'duan tjatër mbret veç mua.
Pastaj zotrote je grua
Nukë them se s'je nga sua
Po yt'at, sot u harrua
Ka njëzet vjet Kastriot
Q'është ndë qieli te Zoti.
Me jot'ëmë e me femijë
Shpyrti për jetë t'u ndrijë!
Nga qielli të shukojnë
Të bësh si të këshëhllojnë
Me gojë t'ime të thonë
Të veç të trashëgosh fronë
Dhe të març Selimnë burrë,
Se ndryshe s'mbretëron kurrë!

«MAMICA»

Mëndjen t'ime ta rrëfeva,
Qënkej m'i-lik seç pandeva,
Nukë paske gjak ndë faqe
Kur panden sa më kënaqe
Me këto fjalë që fole
Me kaqë prova që scële
Për trimatë Shqipëtarë;
Duket nuk i ke dhe parë,
J gjete gafil, i qeshe
Prandaj punove si deshe.
Po Shqipëria s'u shua
Dhe dita u afërua
Që do ndizet si zjari,
Të shoç çpunon Shqipëtari...
Të ligatë që ke bërë
Ndë Turq edhe në të Kishtërë
Edhe gjakn'e Kastriotit,
Murat me fuqi të Zotit
Një ditë dota paguash
Friko, mburru sa të duash,
Prishe, digje Shqipërinë
Më shumë ja çton fuqinë
Më tepër ja ç-ton lnatnë,
Për Turqinë për Muratnë
Sa do të bësh të këqia
S'humbet kurrë Shqipëria
Për Lirinë, Shqipëtarët,
Si të sorrsit dhe të parët,
Kanë vdekur, do të vdesën.
Mburrej q'u ndërrova besën

Dhe panden se i ke ndarë ?
Ti nuk e-nje Shqipëtarë :
Mysylman e të Krishtërë
Janë vëllezër të têrë,
Kanë një gjak dhe një Shpresë
Nuk kanë tjatër besë
Dëshirë kanë Lirinë.
Dhe besë Shqipëtarinë :
Lei të sharat më nj'anë
Se hie nuk të kanë,
Murat, lei qesënditë
Se do të vijë një ditë
Dit'e bardhë, dit'e mbarë.
Që dotë të bêjnë varrë
Nukë të vjen turp një çikë ?
Si s'më binde dot me frikë,
Zure me ca dhelpërira
Dhe me ca fjalë të mira
Të me qeç e të më thuash
Të punoj si që të duash. —
Për këtë qëllim të fshetë
Më flet për Zotn'e-vërtetë,
Guxon më flet për t'im'atë
Që vrave vetë me dorë,
Dhe për njerst'e-mi të tjerë
Që dërgove dhe u therë !
Shini, shini gjakëtorë
Që flet për këta shênjtorë !
Guxon të më këshillojë
Ju thaftë gjua ne gojë.....

MURATI

Ti qënkej vërtet e-marrë,
Nukë lodhej duke sharë ?
Si guxon e flet për mua ?
Nuk e di se po të dua
Të pres kokën ?

MAMICA

E di mirë
Se ti je një egërsirë,
Ëgërsirë si ariu,
Me fytyrë si njeriu.
Nuk të sho dot përpara,
Prandaj dua me të shara,
Murat të të çtoj inatnë,
Të më vraç si dhe tim'atnë :
Thermë me duar të tua
Pse trêmbej sot nga një grua ?
Ti do të më lêsh ndë jetë
Se ke një qëllim të fshetë
Do të m'apsh Selimnë burrë,
Se do të të bênem urë,
Të bênem urë të shkosh
Ndë vënd t'im të mbretërosh.
Jo, Murat, jo ! Shqipëria
S'ësht'jotja. Perëndia
E mërgoftë nga ky tmer.

MURATI

N'ësht'jotja, pse s'e merr,
Kur mund t'a març pa lëftuar

Kur t'a fal me të dy duar
Bë zëmë paç uratë
Fronë që të la yt'atë;
Po të kesh Selimnë burrë
Këtë fron s'e-humbet kurrë.
Bota trashëgonsh për jetë.
Se është trim i vërtetë.
Mirë, mua mos më dunj
Se jam i lik, si më thuaj
Se të verbon zëmërimi,
Po ç të ka bërë Selimi ?
Pse rrëfenj zëmër gurtë
Sot për një trim kaqë t'urtë ?
Ka trima ndë këtë botë
Më të mir'e më të zotë ?
Ti nga se nuk e do vallë ?

MAMICA

S'e dua se e-ke djalë
Mos më trego, e di vetë
Q'eshtë trim me të vërtetë;
Vëndet që ke sot ndë duar
Ay trim i ka zotuar;
Tërë bota e lëvdojnë
Me gisht të tër'e-tregojnë
Selimi s'kam u ndëgjua.
Do të-qe burrë për mua
Të mos a keshe ti djalë.
Këtë trim kaqë të rrallë
Murat preje këtë shpresë
Hiq dorë nga kjo martesë
Se Salimi zëmër-mirë
S'ka sot të tillë dëshirë
Dhe di që s'mund t'a marr burrë.
Kjo krushqi s'bënet dot kurrë :
Mamica të thonë, mori
Të bër'e një gjakëtori ?
Jo, jo ! me fuqi të Zotit.
Sot e bij'e Kastriotit
O Sultan s'trëmbet të vdesë,
Po s'e do këtë martesë.
Therrmë, vritmë, e ke ndë dorë
Po me një Turk s'vë kurorë,
Dua burrë Shqipëtar.
Burrë tjatër nukë marr.
Burri që do-të më marrë
Është mbret për Shqipëtarë,
Dhe këta, si-do që thuaj,
Nuk duan mbret të huaj
Murat këtë dije mirë :
Ose më të sot të tërë,
Dhe m'ep prapë ç më ke marrë
Mbretëri ndë Shqipëtarë.
A, në mos ke këto mënde
Therrmë sot me dorë tënde,
Shqipërin s' pret nga mua,
S'ka nevojë për një grua.
Sot lajme të mira mora :
Të ka shpëtuar nga dora
Shkënder-beu Kastrioti,
Im vëlla, m'a faltë Zoti
N'është e vërtetë kjo fjalë
Në kam sot vëlla të gjallë
Është mbret'i Shqipërisë.

BKSH

MURATI

Burr'a varr do-të kërkosh.
(te Feriti).
Duet të gjêj Fatimenë;
Veshtro mirë Muhamenë,
Ruaje mirë taninë,
Se dëshëron mbretërinë,
Mos na bêjë no-një dhunë.

FERITI

Zot këtë barr'e marr unë :
S'i mbaronet dot qëllimi.

MURATI

Pusho se na vjen Selimi.

## Pamj'e IV
## MURATI, MAMICA, FERITI, SELIMI

MURATI

Qasu, Selim bir tek unë,
Të ndëgjoç ç' bënet këtunë
E shukon këtë zagare ?
Mburret q'është Shqipëtare.
Kjo nepërkë, kjo murgeshë,
Që nderoj si mbretëreshë,
Selim, tani ngriti kokë,
Dhe kërkon të bêjë shokë
Të na vrasë të dy bashkë.
E-keshë dashur me ashkë
Dhe kaqë shum'e-nderojë
Sa me ty dot'a martojë.
Sot më tha me gojë vetë
Për burrë s'do të të ketë !
Tani na punon llagëme,
Me ca gjipura të rrême,
Paska hapur këtë fjalë
Që ka një vëlla të gjallë !
Shqipëtarët e besuan
Prandaj duket u trazuan;
Bir, do prapsur kjo trazirë.

SELIMI

Nuk kam tjatër dëshirë,
Që nesër dot'mbleth ushtarët
Për të shtruar Shqipëtarët.

MURATI

Ashtu, bir, ashtu me rruash,
Me ta bën si të duash,
Dhe kjo që bêri trazimnë,
Që s'pëlqen burrë Selimnë
Kjo që më del e-pa-besë,
Që nesër duet të vdesë.

SELIMI

Të lutem ndegjo dhe mua;
Mamica, zot, është grua,
Mos vërë re se ç'të thotë.

MURATI

Bir, mos m'u lut ndë të kotë;
Rritur me një mëmë shtrigë
Kjo bushtr është shum'e-ligë,
Dhe sa të mira q'i bëra,
Ngjer sot, vanë dëm të tëra,.
Se kjo nepërkë do prerë
Si vëllezëret e-tjerë.

SELIMI

Zot .....

MURATI

Pusho; që të shpëtojë
Binde tani të të dojë,
Dhe për burrë të të marrë.
Të jesh mbret për Shqipëtarë.

SELIMI

Nuk kam, as një nevojë,
Zot, Mamica të më dojë.
Dhë mbretëri nukë dua,
Kur të m'a falij, një grua.

MURATI

Kur nuk'e paskë nevojë,
Mamica s'bën sot të rrojë.
E dojë nuse për djalë
Prandaj e lashë të gjallë;
Fatimen këtë shpresë,
Kish dhe ndaj s'më la t'a vdesë,.

SELIMI

Eshtë turp, zot, nukë dua,
Të vdesë kjo sot per mua;
Eshtë turp për këtë shkak,
Të ndyrim duart me gjak..
Në mos do mua për burrë,
Gjënden të tjerë dhëndurrë
Ng'ata që ke ndënë zgjedhë
Le të marrë dhe të xgjedhë
Vetëm, kurkush mos e ngasë.

MAMICA

Le Selim, le të më vrasë,
Të lutem për krye t'at
Lë të piqem me t'im'at,
Me vëllezëret e tjerë,
Edhe me mëmën emjerë;
Le Selim, të faltë Zoti.
Edhe mos e-gjetë moti.

MURATI

E she bir, ç'është kjo grua?
E ndëgjon ç'thotë për mua
Të Krishtër'e Mysilmanë
Për Zot, për Sultan më kanë
Dhe më falen ngjer të sheshi
Po kësaj s'i dërsin veshi
Kjo është kucedr' e vjetër...
Po t'i ap një burrë tjetër.
Pas fjatës që thuaj tinë
Selim, humbim Shqipërinë,

Dashuri të madhe kemi
S'të ka thënë Fatimea ?
S'të ka rrëfyer Zadea ?

MAMICA

Të tjerë m'a kanë thënë.

SELIMI

Shum'e dinë në vënd t'ënë,
Vetëm im'at s'do të shojë
Dhe kërkon të më martojë
Me ty, të bëjë krushqinë
Që të shtrojë Shqipërinë.
Kshtu e keshillon Feriti,
Zëmër-derri, far'evgjiti.
Se ka kandisur sot mbrenë
Të martonet me Zadenë,
Të marrë mikenë time,
Për madhëri, për fitime,
Do të marr'atë që dua !
Po ngjerka është me mua
Dhe kjo zonjë Shqipëtare
Shtiret si-kur s'di qjë fare.
Dhe Sultanit s'do t'i flasë
Se trëmbet se mos e-vrasë.
Tani beso, zonja ime,
Që s'kam të tjera mendime
Kur jam vluar me Zadenë,
Nukë mund të këmbej benë,
Kur më do e kur e-dua,
Nuk mund të të marr grua ;
S'dua të bëj si të tjerë
Që martonen shumë herë.
Unë sot të flas si mik
Se të shukoj ndë rrezik,
Dhe s'dua të bënem shkak
Im'at të derdhij sot gjak.
Dua zonjë paç uratë
Të të shpëtoj nga im'atë.
Zonjë kam një mik të mirë
Që s'ushqen tjatër dëshirë
Dhe do më tepër nga unë
Që të shpëtosh nga kjo dhunë,
Se të do zonjë, me ashkë
Kur s'martonemi dot bashkë
Dua, kur s'të marr dot vetë
Një miku im të të ketë :
Musa, djal'i Fatimesë,
Zonjë, rron me këtë shpresë.
S'ka guzuar të të thotë
Se të shukonte të ftohtë.
Eshtë trim që nukë gjëndet,
Imirë sa nuk bënet.
Kur leftojë me Sërbinë,
Më kishnë zënë pusinë
Dhe dotë më kishin vrarë
Si kur të mos i kish parë
Rreziknë për të mërguar,
Mikn'e tij për të shpëtuar,
Musa trimi u lëshua,
Deshi të vritej për mua !
Zonjë të lutem me rruash,
Një të tillë trim t'a duash.

MAMICA

Me të birr'e Fatimesë
Nukë bênet kjo martesë,
Se ka dalë nga një grua
Q'është nepêrkë për mua :
Që të kënaqij Sultanë
Më tradhëtoi vëllanë,
I vaftë shpyrti ndë ferrë.
Më ndje se do ta bêsh vjerrë.
Shi se ç'punon Perëndia;
S'i gjajnë fare fëmia.
Zadea që më ka mike
Esht'e urtë dhe besnike,
Vezir Musa, si the vetë,
Eshtë trim me të vërtetë ;
Zot mbase dhe un'e-dua
Po'sot nuk është për mua,
Sot që gjêndem ndë zinxhir,
Nukë jam për një vezir
Lemë, zot, qofsh'i-bekuar,
s'jam gati për të martuar,
Jam gati për nd'atë jetë
Tek mbretëron Zoti vetë !.

SELIMI

Zonjë mos u-bên e-marrë,
Sultani të rëmon varrë,
Nga inati u tërbua.
Unë këtë gjê s'e-dua
Dhe sa jam'i gjallë unë....
Po veziri vjen këtumë.

## Pamj'e VI

## SELIMI MAMICA, MUSA

MUSA

O Selim o mik ç ndëgjova,!
Ç'lajme të këqia msova !
Të mërgojmë këtë gjêmë,
Nga një gur duet të vëmë
Ndë zêmër tênë; ndëgjoni,
U lutem sot të martoni.
Mos qëndro mik të jam falë
Me yt'at ballë për ballë
Selim, ti e di fort mirë
Murati ësht'egërsirë;
Të lutem besomë mik;
Jni të dy ndë rrezik !
Mik në më do si të dua,
Merr sot Mamicën për grua,
Se nukë dua të vdesë !
Selim në jë mik me besë ...

SELIMI

Ç'thuaj zot ? për miqësinë,
Të marr atë që do tinë
Dhe të lê atë që dua !
Ti-që desh vdiqe për mua
Më këshillon këtë punë ?
Selimi s'punon me dhunë
Zot, hiq dorë nga kjo mënde
Se dua motrënë tênde;
Selimi sot mund të vdesë

Po nukë del i pa besë.
Mamica s'është për mua,
Nukë më do, dhe s'e-dua
Se unë dua Zadenë,
Kemi këmbyerë benë
Ndaj lei këto mendime.

MUSA

Të lutet, zot, motra ime,
Besën q'i dhe le më nj'anë ;
Të mos prishesh me Sultanë ;
Nukë do të jetë shkak
Që të derdhet pikë gjak.
Ajo për të mirën tuaj...

MAMICA

Zot gënjeshtra mos na thuaj ;
Zadea këto s'i thotë :
Ç'është ajo grua ndë botë
Që fal miknë që ka vetë
Kur edo me të vërtetë ?
Thuaj që bën këtë punë
Nga frika se mos vdes unë !
Ç'nevojë kini për mua ?
s'u kam dashur as u-dua.
Lemë, lemë të jam falë,
Se mos të zë sot ndë fjalë :
Si-kur të bëj si me thua,
Ç'dotë mendonesh për mua ?
Si-kur të ndëgjoj zotrote ?
Ç'dotë thotë motra jote ?
Mos thuaj zot, këto gjêra
Janë gënjeshtra të tëra.
Ata q'u kanë dërguar
Fort bukur u kanë msuar,
Po u-vete dëm mundimi,
Ndëgjoni ti dhe Selimi;
Në jam sot ndë këtë gjêmë
Fajn'e-ka vetëm jot'êmë.
Ajo, si më kanë thënë,
Ka mbyllyr derënë t'ênë,
Se jot'êmë tradhëtoi
Skënder-benë kur shpëtoi.
Sot thonë ca kokë shkretë
Im vëlla gjendet ndë jetë,
Pa Fatimenë, kjo fjalë
Nukë dot'ish sot përrallë.
Kjo nepërkë kjo zuzare,
Eshtë bijë Shqipëtare,
Përpara quej Ngjelinë,
E bija quej Marinë
Kur tradhëtoi Atdhenë,
Ndërroi besën, e fenë
Dhe me Sultanë u martua !
Ti ke lerë nga kjo grua,
Të ka me burrën e-parë
Trim nga trimat Shqipëtarë.
Fatimea një murgeshë
Sot u bê një mbretëreshë,
Po Zoti që na gjukon,
Mënon po nukë harron.
Këto di, këto të thashë
Si më thanë, se s'i-pashë,
Dhe bêjë si-kur s'i dijë

Se ngjer sot jeshë fëmijë
Dhe keshë të madhe frikë.
Nuk ka gjak as një pikë;
Me dhelpëri, me të rrëme,
Jot êmë më bën llagëme,
Dhe shtiret që më do shumë
Që të më hedhë ndë lumë.
Me të shoqnë një mënd kanë,
Prandaj të gjallë më lanë:
Të m'apin burrë Selimnë,
Kush s'e-kupëton qellimnë?
Më mua duan zuzarët
Të qetojnë Shqipëtarët,
Se lufta nuk u vjen mbarë
Me trimatë Shqipëtarë.
Kanë nevojë për mua
Dhe si shukojnë që s'dua
Sot këtë martes'u vunë
Të më kandisin me dhunë.
Zotërinj, s'ma kishte ënda
T'u thoshë fjalë të rënda,
Po sot më plastë dhe fola
Dhe jashtë nga ruga dolla,
Ashtu si ç'ekanë gratë.
Më ndjeni, paçi uratë,
I dini brêngat e-mia,
Janë shumë të këqia,
Kur s'mundni të m'i-shëroni
Mos kërkoni të m'i-çtoni.
Limëni, qofshi gëzuar,
Unë s'jam për të martuar,
Limëni, paci uratë.
Se kam vetëm këtë natë,
Nesër nukë jam ndë jetë,
Vete te Zot'i vertetë,
Ku kam mëmën e babanë
Dhe vëllëzret.

MUSA

Selim, ç'janë?
Këto fjalë duke sharë?
Kam frikë mos ësht'e marrë?
S ka folur kshtu tjatër herë.

SELIMI

Na mori për njers të tjerë.
Tani vete te Murati,
T'i lutem t'i shkoj'inati;
S'besoj të jet' egërsirë
Të mos ndëgjojë të birrë.
Mamica kërkon të vdesë,
Prandaj nukë na vë besë;
Do, s'do, duet të shpëtojë.

MUSA

Selim, të lumtë kjo gojë!

## Pun'e dytë

## Pamj' e'-I

## FATIMEA, ZADEA

FATIMEA

Njëzet vjet, kurrë s'të thashë,

Për-të ndë dyshim të lashë ;
Fat-zeza, faj të math bëra
Që t'i thashë sot të tëra
S'ț'u luta të mos ja thuash ?

ZADEA

Zonjë, thuaj si të duash :
Ati që dotë marr burrë
Nuk mund t'i fshej gjë kurrë,
S'mund t'a gënjej kur e-dua.

FATIMEA

Je çup'e s'të pushon gjua :
Mëndje-shkurtër kokë erë,
Ke folur dhe me të tjerë,
Ndyshe, qysh u hap kjo fjalë :
«Skënder-beu ësht'i gjallë» ?
S'u mendove se Murati
Mos marroset nga inati,
Dhe mos zêrë trimn'e-gjorë
T'a therij vetë me dorë ?
Atë që panden sot djalë ?
Pa kerryer këtë fjalë
Pse s'ț'u-tha gjua ndë gojë ?
Nuk u trëmbe mos pësojë
Ay princ që kam shpëtuar,
Për të cilin jam munduar
S'e m'a kanë lënë barrë
T'a rruaj për Shqipëtarë ?
S'u trëmbe me një kuvënd,
Se mos humbaç miknë t'ënd ?
Hape bijë një trazirë
Që mbase s'na del për mirë.

ZADEA

Jo moj nëne, nuk fola
Me njeri fjatër se s'dolla,
Për kokën t'ënde, për Zonë
Vërë re mirë se ç'thonë ;
Thonë ; me fuqi të Zotit
Rron i bir'i kastriotit ;
Skënder-beu për ca vetë
Eshte sot ndë këtë jetë ;
Po këtë fjal'e merr era
Si shumë fjalë të tjera.
Nukë thonë, nukë thanë
Që ti gënjeve Sultanë,
Q'i dhe djalën t'ënd e-theri
Dhe kshtu shpëtoi Skënderi.
S'thonë sot se Skënder trimnë
Mbreti e-panden Selimnë
Të bir'e Sevdasë ndjerë.
Nukë thanë nonjë herë
Se sot Selim'i vërtetë,
Eshtë vezir Musa vetë
Që shkon për yt bir taninë ;
Këto s'i thonë s'i-dinë.
Këto llagëmet e-tua
Në janë kshtu si m'i-thua,
Dot'i kishnë sot treguar
Po të keshë kuvënduar
Jo zonjë, princ Shqipëtari
Që ke shpëtuar nga varri.
Do-me-thënë Skënder beu

Që dolli prapë nga dheu,
S'është ndë rrezik, kam shpresë

FATIMEA

ndë këto fjalë s' kam besë.

ZADEA

Ja tek vjen e do-të shomë.

## Pamj'e II

## FATIMEA, ZADEA, SELIMI

(tani e tutje,- Selimi njhe vetëhenë se msoi nga Zadea q'është Skënder-beu, i bir'i Gjon kastriotit.)

SELIMI (te Fatimea.)

Zonjë të lutem besomë,
Të mirat që më ke bërë,
Ndë jetë t'ime të tërë,
S'ti çperblej dot. Tjatër herë
Kuvëndojmë gjat'e-gjerë,
Sot vetëm të them një fjalë
Zonjë të më kesh si djalë,
Së të kam dy herë mëmë.
Tani ç'udhë dotë zëmë ?
Sot e tutje s'mund të fshiem,
Që tani duet të njihem
Se kam motrën ndë rrezik
Nga një njeri fort i-lik
Murati, qën i-pa besë,
Që nesër kërkon t'a vdesë
Po të mos më marrë burrë !
Kjo pumë s'bënet dot kurrë
Se s'merr motra të vëllanë.
Sot duet të vras Soltanë
Dhe të marr gjak për t'im'atë.

FATIMEA

Jo bir, jo bir, paç uratë,
Bir, mos u bën zëmër-gurtë
Në je vërtet trim i urtë,
Të tilla fjalë mos thuaj
Dhe për Mamicën mos ndruaj.
Po të kesh tek unë besë,
Mamica nuk dotë vdesë.
Le Sultanë të jam falë
Të të pandejë për djalë ;
Të lutem mbaj vetëhenë
Në do të shpëtosh Atdhenë ;
Të lutem zot mos gënjenesh.
S'erdhi koha të rrëfenesh.

SELIMI

Kur dot'a gjej më të mirë
Se sot ndë këtë trazirë ?
Gjithë bota, pasha Zonë,
Rron, rron Skënder- beu, thonë,
Dhe ushtarët Shqipëtarë
Duan t'a shonë më parë.
Sot, të dua, shqipëria ;
Shpëton, zonjë nga Turqia;

Dhe Muratnë mund t'a vras,
Se gjith'ata që ka pas
Që mbrojnë mbretn'e Turqisë,
Janë djemt'e Shqipërisë.
Vërtet njers me besë janë,
Vërtet vriten për Sultanë,
Po kur të dal e t'u them :
« Eni me mua, o djem,
Jam i bir'i Kastriotit ! »
Gjithë, për ëmër të Zotit,
Tok me mua do të vinë
Të shpëtojnë Shqipërinë.

FATIMEA

Zot, ndëgjo se ç-them dhe unë :
Nuk'e dimë këtë punë,
Se Sultani, me të parrë
Shqipëtarët i ka ndarë :
Myrylman'e të Krishtërë
Sjanë me një mênd të tërë;
Shumë vjet ndë zgjedhë rrojnë,
Dy, tri besë, sot besojnë,.
Populli nukë ka besë,
Le të thotë, të Thërresë ;
Nukë çfaqej, ? të kërkojnë ;
Çfaqej ? mbase s'të besojnë;.
Zot, që ditën që ke lerë,
Të kam dashur kurdoherë ;
Në kë sot jetën nga unë,
Zot, lemë të mbaroj punë.
Murati duet të vdesë
Se rrojta me këtë shpresë.
Po do-të vdesë nga unë,
Se ndaj kam ndênjur këtunë,
Prandaj e mora për burrë,
Prandaj s'ju largnash kurrë.
Sot ky nder është për mua
Dhe shpërblim tjatër s'të dua,
Vetëm sot të më ndëgjosh,
Nga unë të mbretërosh
Ndë Shqipëri të bekuar
Se nga unë ke shpëtuar

ZADEA

Zot, në më do, si të dua,
Në ke dhëmburi për mua,
Në të vjen rêndë nga lotë
Që derth,. .ndëgjoe ç të thotë.
Pse të ndyresh më një gjak,
Që do-të derthç nga një plak ?
Zot, mund të mos dalë mirë
T'a vëç sot me nj'egërsirë,
Le tjatër të vrasë mbrenë,
Ti në do vërtet atdhenë,
Ti sot me trimëri t'ênde,
M'atë zêmër, m'ate mênde,
T'a nderosh duke lëftuar,
Të mos quesh gjakëtuar.
Vërtet, thërret dit'e natë
Gjaku që kërkon yt'atë,
Po, neve, zot, kemi frikë
Për tyi duajna një çikë.....

SELIMI

T'u dua ? u dua shumë :
Sa net kam gdhirë pa gjumë !
Kudo që vej'e leftojë,
Nat'e ditë të kujtojë,
Mike për ty lakëmojë,
Luftën, dojë t'a fitojë,
Që të zotoj shumë vënde
Ti vë ndë-në këmbe tënde;
Ahere jeshë bir mbreti,
Tani kjo shpresë s'më mbeti ;
(te Fatimea)
Tani s'kam tjatër dëshirë
Veç të të çpërblej tët birrë
Që le të theret për mua !
Dhe më pyetni n'u-dua ?
Dit e fundit sa të vijë,
Për ju dotë më godijë
Kjo zëmr'e shkretë që shëmba,
Dhe gjaku që kam ndë rrëmba,
Eshtë juaji, urdhroni,
Do të bëj si të më thoni
Dhe si të më këshilloni,
Vëtem u lutem kujtoni,
Kujtoni, motrënë t'ime,
Gjëndet ndë shumë shtrëngimë,
Eshtë shum'i math armiku ;
Shpëtonjeni nga rreziku,
Në mos po nesër, t'a dini,
Ja më shini, ja s'më shini.

FATIMEA

mos u trêmb për këtë punë,
Se këtë barr'e-marr unë
(Selimi del).

## Pamj'e III

## FATIMEA, ZADEA

FATIMEA

Trêmbem se ky trim me pallë
Nga fjala që tha mos dalë
Dhe mos.....

ZADEA

Nga fjala s'del kurrë
Se nuk ësht'i tillë burrë.
Tjatër frikë më ka ryrë :
Ti vetë sot me ç'menyrë
Do-të mbaç fjalët e tua ?

FATIMEA

Do të t'a them, dua s'dua,
Që të më ndish dhe ti vetë :
Musa Selim i vërtetë,
Për Mamicën ka dëshirë,
Shum'e do.....

ZADEA

E di fort mirë
Po s't'a kupëtoj qellimnë.

FATIMEA

Duet të shtyjmë Selimnë
Sultanit t'i-bêjë varrë,
Për dashuri që ka marrë.

ZADEA

Zonjë, këto fjalë ç'janë?
Të vras'i biri babanë!

FATIMEA (me vethe)

Baba! duet të mba gjunë
Se po të dijë c'di unë.
Zadea sot, më prish punë.

(te ZADEA)

Mos të vijë, bija ime,
Rêndë për këto mejtime:
Ndaj, lashë me këtë shpresë,
Musanë, t'im bir, të vdesë
Dhe bêra Selmnë djalë.
Prandaj e-lashë të gjallë.
Prandaj e-rrita si njellë
Për këtë qëllim të thellë,
Dhe si-do që jam kaurkë.
Prandaj kam shkuar për Turkë,
Njëzet vjet prandaj kam vuar,
Pra ndaj këtu jam martuar,
Ndaj ndênja në këtë prak,
Që të mund sot të Marr-gjak,
Gjakn'e Sultanit Turqisë
Q'ësht'armik'i Shqiqërisë
Sot, Murat, zêmër këlliri,
Dotë vritet nga i biri,
Të marr me fuqi të Zotit,
Gjakn'e Janit Kastriotit
Që më dha kur vdiq, të birrë
Që t'a ruaj me dëshirë
O'vëlla, vëlla, paç ndjesë,
Të vranë me të pa, besë;
Ngjelina, nukë gënjeu;
Se, ja ku rron Skënder- beu!
Ng'ajo jetë ku ke vatë.
Dërgoi shpres'e uratë.
Që të zêrë ndë vënd t'ênë
Fron'e artë që ke lênë;
Të lëftojë me Turqinë;
Të nderojë Shqipërinë,
Sultan, Sultan, dotë vuash,
Erdhi dita të paguash
Të këqiat që ke bêrë
Ndë Turq'e ndë të Krishtërë!

ZADEA

Të lutem, rrëfem'o mêmë,
Qysh do të bënet kjo gjêmë

FATIMEA

Bijë s'është puna jote,
Mos kërko t'i dish të têra;
Ndëgjo sot se ç'punë bëra:
Dërgova kur dolli mbreti,
Të na vijë Muhameti.
Nga nakar'i math që kanë,

S'do vëllai, të vëllanë,
Varr'e shok-shokut rëmojnë,
Me llagëme që punojnë.
Ja tek vjen.....

ZADEA

Zonjë, për ç'pune!

FATIMEA

Dotë jesh vetë këtunë,
Po të mos flaç as një fjalë.

## Pamj'e-IV

## FATIMEA, ZADEA, MUHAMETI

MUHAMETI

Zonj'e madhe, të jam falë.

FATIMEA

Zot, t'i falesh Perëndisë
Për të mirën e Turqisë.

MUHAMETI

Gjithë punët mirë janë
Zoti na faltë Sultanë,
Se është mbret i Turqisë
me fuqi të Perëndisë.

FATIMEA

Zot, lei këto dollape,
Dhe zêmrën pa frikë hape;
Sot në do të mirën t'ênde,
Mos më folë me dy mënde.
Ti di më mirë se unë
Që të punon mbreti dhunë,
Po mbase vesh s'ke dhe marrë
Që do të të bêjë varrë,
Dhe sot Murati, si thonë,
Kërkon të prishij zakonë
Të mos munç të mbretërosh
Kur të lêrë fronë bosh;
Ndaj mendonet me vezirë
Të bjerë ndë fron të birrë.

MUHAMETI

Nukë gjëndet mbret m'i mirë.
Jm vëlla, zot'i Turqisë
Me fuqi të Perëndisë,
Për jetë të mbretërojë
Dhe sa malet të na rrojë.
Po, qoftë lark, kur të vdesë,
Unë dua, besa-besë,
Të mbretërojë Selimi
Zêmër-miri, burrë trimi.

FATIMEA

Duket s'ke besë tek mua,
Se Murati më ka grua,
Dhe Musa Topja veziri
Ti panden se ësht'im biri.

MUHAMETI

Vezir Musa, trim me fletë,

S'ësht'yt bir !

FATIMEA

Me të vërtetë,
Vezirë nuk e kam djalë.

MUHAMETI

Zonjë, ç'janë këto fjalë ?

FATIMEA

Ndëgjo, zot se-si ka gjarë,
Po të betonesh më parë
Që do-të më dukesh mik
Mik për kokë dhe besnik;
Këtë miqësi që dua
Eshtë për ty, dhe për mua,
E dobishme.

MUHAMETI

Muhameti

Të betonet si bir mbreti,
Qe sido qoftë kjo fjalë,
Nga goja të mos i-dalë,
Dhe sa të rrojë të jetë
Për nder të math dot'a-ketë
Zonjë që të të shërbejë
Ndë ç'do pun'e ç-do nevojë,
Se nukë trënbet të vdesë

FATIMEA

Besa - besë ?

MUHAMETI

Besa - besë

FATIMEA

Zot Shqipëtarët u ngrenë . .

MUHAMETI

Dhe thonë për Skënder-benë
Që rron ! sot u hap kjo fjalë.

FATIMEA

Kjo fjalë s'është përrallë
Ay q'e-hapi s'gënjëu,
Esht'i gjallë Skënder-beu :
Vezir Musa, trim me fletë,
Eshtë Skënder-beu vetë.

MUHAMETI

Zonjë, pse tallej me mua,
Me këto fjalë që thua ?
Lei zonjë, këto fjalë,
Skënder-beu s'ësht'i gjallë.
Ti e-di që s'mund të jetë
Se Muratit ja dhe vetë
Dhe këtë foshnjë Murati
E dërgoi tek i-ati,
Me dorë të ti e vrau.

FATIMEA

Ndëgjo puna se si gjau
Murati si eqërsirë,

Ahere vrau t'im birrë,
Për Skënder-benë ja dhashë
Dhe këtë të gjall'e-lashë,
Se duej për Shqipëtarë
Që m'a kishnë bërë barrë
Prandaj zot, ndënja këtunë
Që të mbaroj këtë punë.
Zot, tani q'i-di të tëra
Punët e mia që bëra,
Duet, si me the tani
Të më ndish, e të të ndi.
Në do zot, që të kesh shpresë
Të mbretërosh kur të vdesë,
Yt vëlla, dreqi t'a-marrë,
Të jesh mik me Shqipëtarë,
Edhe kur të mbretërosh
Benë që dhe mos harrosh,
Se pa-besia, s ka dalë
Për mbarë kurrë.

MUHAMETI (me vëtëhe)

Kjo fjalë:
«Skënder-beu rron nde jetë»
Të jetë vall'e vërtetë?
Zonjë m'a ep me të shkruar?
Se s'është për të besuar.

FATIMEA (shkruan)

Merre, zot me dorë t'ime
E shkrova.

MUHAMETI

Këto shërbime
Dhe besa që ke tek unë,
Dotë na mbarojnë punë. (del)

## Pamj'e V

## FATIMEA, ZADEA,

ZADEA

Zonjë. me të tillë mik,
Më duket re ndë rrezik;
S'e di pse. po këtë burrë
S'e kam patur ndë nder kurrë?
S'e-pe kur u ngre nga sheshi?
Jku ndë-në buzë qeshi
Trêmbem mos na tradhëtojë.

FATIMEA

Jo, jo, se na ka nevojë
Vërtet s'është burr'i-mirë
Po ka të madhe dëshirë
Të benet Sultan dhe vetë
Me c'do menyrë të jetë;
Ay rron me ktëtë shpresë,
Prandaj sot i- vura besë.

ZADEA

Po s'ësht'e-ligë kjo punë?

FATIMEA

Sot një dëshirë kam nuë:
Të lë pas ndë këtë jetë
Skënder-benë të vërtetë
Dhe Mamicën, nga zinxhiri
T'a shpëtoj.

ZADEA

Na vjen veziri

## Pamj'e VI

## FATIMEA, ZADEA, MUSA

MUSA

Zonj'e mahe të jam falë;
Esht'e vërtetë kjo fjalë
Që gjegja prej Muhametit?

FATIMEA

Po ç-të tha vëlla i mbretit

MUSA

Unë qênkam Skënder-beu!

FATIMEA

Muhameti s'të gënjeu;
Unë që të kam shpëtuar,
Ja dhashë sot më të shkruar
Duket e gjete te shkalla
Se tami dolli nga Salla.

MUSA

Zonjë, vërtet ashtu gjqu,
U-hodh e më zu nga krau
Dhe më tha.....

FATIMEA

Po s'e-besove?
Dhe ike nukë qëndrove?
Ndëgjo puna si ka gjarë
Tani njëzet vjet më parë:
Zot, Murati pastë nêmë,
Vrau yt'at e jot'ême,
Gjithë njerst'e-tu; ndë ballë
Desh të të lêrë të gjallë;
Jeshe gjashtë muajsh djalë.
Besën, o zot, t'a ndërroi,
Dhe Skënder-bej t'ëmëroi.
Një ditë, dy shqipëtarë
U qasnë këtu pa parë,
Nukë di si e-gënjyen,
Nga pallasi të rrëmbyen
Dhe të prunë, zot tek unë
Kur dëgjoi këtë punë
U-marros Sultan Murati.
U tërbua nga inati,
Vuri njers të të kërkojnë
Dit'e natë të përgjojnë
Të të sjellin, me një fjalë
A të vdekur, a të gjallë
Kur pashë këtë mynxyrë,

U menduash me ç'menyrë
Mund të të shpëtonte jeta.
Zot, bëra sikur të gjeta
Dhe mora t'im bir Musanë,
Dhe vajta gjeta Sultanë.
Si-do që jeshtë versnikë
Keshë prapë shumë frikë
Mbreti mos të kupëtojë
Dhe mos nukë më besojë:
Po puna më vate mbarë,
Se Murati me të parë,
Nga inati që kish marrë,
Rrëmbeu Musën e gjore
E theri vetë më dorë,
Dhe panden sot se ka vrarë
Skënder-benë Shqipëtarë!
Për këto shërbime mua,
Sultani më mori grua,
Se Sultana, për fat t'onë,
J-kishte vdekur lehonë.
Më dha e rrita jetimnë
Të birin e-ti Selimnë.
Më bëri shumë të mira,
Më dha shumë darovira
Më la këtu mbretëreshë
Bashkë me pjellët që keshë
Bërë me burrën e-parë
Arianë Shqipëtarë.
Mbreti të panden t'im bir
Ndaj sot të bëri vezir,
Prandaj me fuqi të Zotit,
Sot rron djal'i Kastriotit
Këtë gjê që të rrëfeva,
Më ndje se ngjer sot t'a fsheva
Të lashë të bënesh burrë
Që të mos trëmbemi kurrë.
Sot që je shum'i-ndëgjuar
Me punët që ke punuar,
S'është fjal'e pa besuar
Të jesh princ'i Shqipërisë
Me fuqi të Perëndisë;
Sot Shqipëtarët u ngrenë
Dhe kërkojnë Skender-benë
Zot, më duket kjo trazirë
Eshtë për ty fort e-mirë,
Eshtë koha të jesh burrë,
Te tregonesh, në mos kurrë
Puna ime u mbarua.

MUSA

Këtë që bêre për mua
Kurrë s'përçblenet me fjalë.
Nga ti kur qênkam i-gjallë,
Zonjë, për këto shërbime,
Dote bêj detyrën t'ime.
Në mos pagofsha si dua
Këto të mirat e-tua,
Të ta dijë Perëndia
Edhe gjithë Shqipëria
Moj zonjë, këtë të mirë,
Për mua humbe të birrë!
Këtë ndë botë të têrë
Kurrë njeri s'e ka bêrë;

Ke bêrë të madhe gjêmë,
Të dijë ngjer sot për mêmë,
Të kâm dashur si jo tijatër,
Dotë te dua mê tepër
Tani që s'të kam gjê fare !
Qênkej trime Shqipëtare ;
Dotë të kem nde natyrë
Për shêmbëll e për pasqyrë,
Të rrëfenem trim ndë jetë
Dhe Shqipëtar i vërtetë.
Më vjen keq sot për babanë
Po më shumë për Musanë,
Zoti mbase m'a-bên mbarë
Dhe s'u-lê gjaknë pa marrë...
Më ndje, me këto mendime,
Harova motrënë t'ime.
Zonjë, si të keshë thênë,
Ndë dashuri keshë rënë,
Dhe te kjo motër më besë
Ngjer sot keshë tjatër shpresë :
Dojë të më mirr për burrë !
Pse s'më tha gjê gjaku kurrë ?
Po dhe ti kur kupëtove
Këtë mall, pse s'më ndalove ?
Dhe shumë herë më gojë,
Psë më shtyje që t'a dojë ?
Pse, pse për këtë martesë,
Më mbaje, zonjë me shpresë ?
Këtë dashuri të shkretë
Përse vall'e-rrite vetë ?
Përse, me motrënë t'ime .....

FATIMEA

Se ka të tjera qëllime
Murati : nuk'e-lê kurrë
Që të marre tjatër burrë
Vec të birr'e-ti Selimnë,
Po dhe ti ja di qëllimnë,
Ndeza dashurinë t'ënde
Që të mos jesh me një mênde,
Me Sultan'e-mallëkuar
Që do t'a vêrë ndë duar
Dhe Selimit do t'ja apë !
Do zot, që të të them prapë
Pse të shtyta që t'a-duash ?
Që të mos trêmbesh t'a-ruash,
Dhe t'a-shpetosh nga inati
Që mori për të Murati.
Sot motra jote mundonet:
Në mos dashtë të martonet,
Nesër, të rrojë s'ka shpresë.
Dotë lêsh motrën të vdesë ?

MUSA

Punën që kërkon Murati
E-do Zoti, e do Fati :
Mamica të mos mendonet,
Me Selimnë te martonet.
Unë sot, si-do q'e dojë,
Ja thashë vetë me gojë,
Po ajo më vu përpara
Dhe më ndoqi me të shara ;
Po tani që dotë msojë
Se ç'më ka, do më besojë

Dhe dotë marrë Selimnë
Mikn'e dashur, burrë trimnë;
Si ky, të tjerë dhëndurrë
Nukë mund të gëjmë kurrë.

FATIMEA

Zot, ç janë këto kuvênde ?
Dotë lêsh motrënë t'ënde
Sklave tek një egersirë
Që do t'i-apë te birrë ?
O Zot, nuk e-di Sultaë
Që të ka vrarë babanë,
Që... .....

MUSA

Selimi s'i ka gjarë
Dhe njerst'e-mi s'i ka vrarë;
Zêmër-mirë që s'ka shokë,
Prandaj e kam mik për kokë.

FATIMEA

Kur ka nja baba të tillë ?

MUSA

Bêri ferra trëndaifilë.

FATIMEA

Zot, Mamica nuk'e-do,
Të lutem mos e-mundo
Edho mos e sëkëlldis.

MUSA

Dotë vetë t'a-kandis.(del)

## Pamj'e VII

## FATIMEA, ZADEA,

FATIMEA

Hallet e brëngatë e-mia
Bijë, m'i çton Perëndia,
Se si-do që kam punuar
Për qëllimn'e-shëntëruar,
Kur duket se mbaroj punë
Del një ndalim, del një Dunë
Dhe s'harrij atë që dua.
Nukë di c'është me mua,
Ngjer sot kam vuar pa masë;
Po dreqi dotë pëlcasë
Dhe një ditë do të vijë
Zot'i-math do të më ndijë.
Ndëgjove, bijë ç më tha ?
Kupëtove ç'qëllim ka ?
Të tjera mundonem unë,
Musa kerkon tjatër punë
Dhe sido që më beson,
Nga mbreti trëmbet s'guxon,
Jo vetën s'guxon ta vrasë
Për fat të keq këtë shtazë,
Po rend bashkë më Sultanë
Të marrë motra vëllanë !

ZADEA

Moj nëne mos u-mundo,
Se Mamica burrë s'do
Dhe princi s'merr tjatër grua,
Se më do dhe vdes për mua:
Mos u-trëmb për këto gjëra.
Princi sot i-di të tëra
Dhe s'mund të këmbejë benë
Tani që nje vetëhenë:
Mamicën sot s'mund t'amarrë
Kur kanë një gjak, një farë.
Po një gjë s'kupëtoj dot,
Me këto që bëre sot:
Musa nga zotrote ndjeu
Q'është vërtet Skënder-beu,
Dhe vulose me dy duar
Që ti vet'e-ke shpëtuar!
S'të kupëtonet qëllimi:
Kur të rrëfenet Selimi,
Bota që dot'a ndëgjojë
Zonjë, qysh dotë besojë
Q'ësht'i birr'i Kastriotit?
Fole, për ëmër të Zotit,
Skënder-be n'është Selimi,
Ç'është vezir Musa trimi?

FATIMEA

Njeri këtë s'bën t'a dijë
Dhe si-do që të kam bijë
Mos prit që t'a msosh nga unë
Kur nukë di të mbaç gjunë.
Mos e bën fjalën të gjatë;
Duro bijë, paç uratë,
Dotë shoç se ç'bën jot'ëmë.
Tani kuvëndet t'i-lëmë;
Duro, dotë kupëtosh
Jot'ëmë nukë rend bosh
Se lakëmon për Atdhenë.
Duet të sho Muhamenë,
Të shukojnë me Sultanë
Qyeh dot'a kërrejmë mb'anë.

## Pun'e-tretë

## Pamj'e-I

## MAMICA, MUSA

MUSA

Motër, të dojë për grua!
Sot ky zjarr vërtet u shua,
Tani si vëlla të dua,
Po zëmëra m'u copëtua
Shumë herë dashuria
Lindetë nga miqësia,
Po sevda kush-do që ka
Më pahir bënet vëlla:
Ngjer sot të dojë për grua,
Tani lipset të të dua
Për motër-ndaj zëmra ime
M'u bë sot, copa, thërrime!..

MAMICA

Po dhe unë zot, të dojë

Dhe shumë herë rëkojë
Ndëgjo se ç'më tha një herë
Ditën që vdiq mëm'e mjerë :
« Bijë, duaj Fatimene
« Se sido që rron me mbrenë,
« Eshtë grua zëmër mirë.
« Mbreti të do për të birrë
« Po ti të mos bindesh kurrë,
« Bijë mos març tjatër burrë,
« Veçnga dor'e-Fatimesë,
« Se është mike me besë.»
Fatimea të kish djalë,
Prandaj zot, me këto fjalë.
Pandeva se kish dëshirë
Të m'apij burrë të birrë
Zot, prandaj s'keshë besuar
Fjalët që keshe ndëgjuar,
Që më kish vrarë vëlanë
Për të kënaqur Sultanë.
Prandaj, kjo zëmër e shkretë
Të deshi me të vërtetë ;
Prandaj tek ti keshë shpresë
Kur mendonesh për martesë ;
Që të marr burrë Selimnë,
Ndaj, s'mbajta dot zëmërimnë
Dhe të vura sot përpara
Me kaqë shumë të shara

## MUSA

Motrë, me këto kuvënde
Mos më vre me dorë t'ënde?..
Kur nukë dijë se ç'jeshë
Kur nukë dijë ç'të keshë,
Të dojë mike me besë
Dhe gënjenesh me një shpresë.
Tani q'u-gjënd e vërteta,
M'u prish shpresa, m'u-nxi jeta !
Detyra që kam për tynë ;
Më ndalon sot të mbyll synë ;
Nevoja që ke për mua
Më bën të rroj, dua, s'dua.

## MAMICA

Po dhe unë zot, kur m'sova
Të vërtetën sot, rëkova....
Vërtet shumë më gëzoi.
Kjo lajmë, po më lëndoi.
Zjarri që keshë m'u-shua,
Po zëmra m'u-përvëlua.
Sot një gjë më mabn ndë botë,
Mëndja ime që më thotë :
« Tek ay që keshe shpresë
« Gjeta një vëlla me besë ».
Zot, kur të paskam vëlla,
Nga një mëm'e një baba,
Kur paskemi zot, një gjyshe,
Duet të duemi ndryshe.
Kujto ! ndërrove sot ëmër,
Dhe kemi një gjak ndë zëmër;
Ky gjak që kemi të larë
Sot, kërkon gjaknë të marrë !
Kujto, Murati ç'ka berë,
Vrau njerst'e-tu të tërë

Mos harro se sot Atdheu,
Pret shpëtim nga Skënder-beu.

MUSA

E-di se djal'i-kujt jam,
E di detyrën që kam
Dhe do-të marr nga Murati
Gjaknë që kërkon im'ati,
Më ndifte Zot'i vërtetë,
Se kur e do dhe ti vetë,
Kjo vrasij nuk është dhunë.
Po pa bërë këtë punë
Motrë të lutem ndëgjomë...

MAMICA

Vëlla, mos m'-u lut, urdhromë.

MUSA

Motrë kur s'të marr dot vetë,
Dua një mik të të ketë.
Ndaj duet,-mós zëmëronesh
Me Selimnë të martonesh.
Të ligën t'ende, besomë,
S'e dua kurrë.....

MAMICA

Ndëgjomë :
Kur nukë je ti për mua,
Burrë tjatër nukë dua
Selimi me të vërtetë
Esht'i mir'e trim me fletë,
Vërtet s'ka shokë të tjerë,
Po nga Murati ka lerë.
Nga të ligat e-këtinë
Qëroe, lae sot tinë ;
Kur të vëç mbretnë ndë varr
Bjermë Selimnë t'a marr.

MUSA

Vete t'a vras se s'habitem
Motrë, po mund që të vritem,
Che kur të mos jem i-gjallë
Për zot, kush do-të të dalë ?
Ndaj të lutem të marc burrë
Motrë të mos trëmbem kurrë
Të mos të të lë të shkretë,
Pastaj di se ç punoj vetë.

MAMICA

Kur të kem të tillë vjerr,
Kur të sho të tillë tmer,
Më mirë deti më mbytë
Më prahir sot të mbyll syttë
Dhe të më mbulojë dheu!
Në jë vërtet Skënder-beu,
Ecë vetëm a me shokë,
Bjeri Muratit nde kokë.
Po c'dreq na i-sjell këtunë ?

MUSA

Motrë, na punuan dhunë,
Se shukoj, bashkë me mbrenë
Tradhëtorë Muhamenë.

## Pamj'e II

### Mamica, Musa, Murati, Mohameti, Feriti.

MURATI

Te kjo çupë bukuroshe,
Pse ke ardhë, ç'fjal'i-thoshe?
S'ka qëllim për të martuar
Me t'im bir?

MUSA

Pun'e mbaruar;
Dotë martonet princesa
Me Selimnë.

MURATI

Po martesa,
Kur do të bënet?

MUSA

S'e-di,
Po të duash që tani.....'

MURATI

Po s'msove dhe tjatër fjalë?
Skënder-beu 'ësht'i gjallë?
N'ësht'e vërtetë kjo punë,
Rrëfema t'a-sho dhe unë.

MUSA

Ti e-nje fort Skënder-benë
Se sho këtu Muhamenë
Tradhetorë t'yt'vëllanë.

MUHAMETI

Punoj për t'im zot Sultanë
Dhe sot bëj detyrën t'ime.

MUSA

Të di, me këto shërbime
Llagëme do t'i punosh.

MURATI

Këto fjalë janë bosh,
Një fjalë tjatër të zëmë:
Kjo letr'është nga jot'ëmë,
Ndëgjo më parë ç'ka shkruar
Të më përgjigjesh pa ndruar:
« Kam gënjyer me Sultanë,
« J dhashë t'im bir Musanë,
« Murati, këtë të gjorë,
« E theri vetë me dorë
« Se Skënder-ben'e pandeu;
« Prandaj rron sot Skënder-beu
« Vezir Musa trim me fletë
« Esetë Skënder-beu vetë.»
Janë këto të vërteta?

MUSA

Të tëra, t'u-ngjatë jeta

MURATI

Musa, thuaj të vërtetën.

Në do sot të shpetosh jetën.

MUSA

Unë Musa nukë jam,
Folmë me ëmër që kam.

MURATI

Sot më duket se u-ç'mënde,
S'të vjen keq për jetën t'ënde ?

MUSA

Bën até që ke ndër mënde
Dhe lei këto kuvënde.
Je i-egër si një shtazë,
Mendoneshë të të vrasë,
Se im at që ti ke vrarë,
Gjaknë kërkon të të marrë ;
Po nuk më la tradhëtori.
Nga rreziku sot të nxorri ;
Po ky gjak s'mbetet pa marrë
Se ka shumë Shqipëtarë.
Sa nukë dijë se ç'jeshë,
Për zot, për Sultan të keshë,
Ngjer sot për ty kam punuar,
Me besë të kam shërbyer,
Dhe ndë rrezik ryta vetë
Që t'i fal Selimit jetë.
Jo, jo ! me fuqi të Zotit,
Sot i bir'i Kastriotit.
Nukë trëmbet se mos vdesë.

MURATI

Me këto fjalë ke shpresë
Të më xbuç ndaj për t'im birrë
Thuaj q'i-ke bërë mirrë ;
Po Musait Këto gjëra
Ja kam paguar të tëra
Dhe sot e bëra vezir
Se ka shpëtuar t'im bir.
Për tyj s'kam as një detyrë
Se sot ti ke dy fytyrë
Je Skënder-bëu më thua,
Dhe dëshëron të vraç mua ;
Kërkon të më vraç me dhunë,
Po dotë më shoç ç'bëj unë :
Sa jam i-mirë për miqtë
Aq i-keq jam për të liqtë.
Nga unë sot, s'-ke shpëtim ;
Mos u mbaj me djalën t'im,
Se nukë më shkon inati

MUSA

E-di ç'derr është Murati,
E-di mirë se kjo shtazë
Skënder-benë do të vrasë !
Të di mirë ç'njeri je,
De ç'zëmër të ligë ke,
Egërsirë si ariu
Nukë frye mish njeriu.
Jo, s'të përmënda tët birrë
Që të të marr me të mirë,
Po rrëfeva trimërinë

Që kam-pasur ngjer' taninë
Sa jëshë Musa vëziri,
Që të të mbushet fiqiri
Ç'mund të bëjë Skënder-beu
Tani që dolli nga dheu,
Si-kur t'a lësh sot të gjallë,
S'i-del dot ballë për ballë.
Murat në do vetëhenë,
Prishe, vrae Skënder-benë,
There vetë Shqipëtarë
Të të mos të bëjë varrë.
Sot s'rroni dot që të dy
Se s'të shukon dot me sy.

MURATI

Derr i-derrit, shum'u-mburre,
Po të keq kokës i vure!
Ferit, Skënder-be gjauri,
Ndë të math inat më vuri,
Merre mbylle tek të duash;
Mos harro, ashtu më rruash,
Të vëç t'a-ruajnë mirë.

MUSA (te Mamica)

Motër, keshë një deshirë,
Fati s'më la t'a-mbaroj
Që të mund të të shpëtoj.
Dashtë Zoti, moj e mjerë,
Dhe të shpëtofshin të tjerë.

(del me Feritnë)

## Pamj'e-III

### MURATI, MUHAMETI, MAMICA

MURATI

Dhe ti tani mos kij shpresë,
Skëndër-beu dotë vdesë.
T'ënd vëlla ndë varr e-ngule,
Tani mos u-mbaj fodulle,
Mos u mburr po qaj me lot,
Se prapë nuk'e shë dot.

MAMICA

Jo Sultan jo! nukë qaj,
Se im vëlla vdes pa faj,
Sot im vëlla më nderon
Se trim e burrë qëndron
Dhe me fjalë që të tha,
E-njo vërtet për vëlla;
Dotë nderonet ndë botë.
Për ty bota ç'dotë thotë?
O Murat, do të të shajë.
Të qaj? vërtet dotë qajë,
Sikur të qënkej harruar
Dhe të të kishte lëvduar
Që të të shkonte inati.
Ay frikë nukë pati,
Me gas të math të rrëfeu
Q'është vërtet Skënder-beu.
Më gjithë rrezik q'e-gjeti,
Të foli si një bir mbreti

Dhe i-tillë dotë vdesë.

MURATI

Po të duash ti ka shpresë :
Në do të shpëtosh vezirë,
Të martonesh me t'im birrë.

MAMICA

Jo Sultan jo ! këtë fjalë
Merre prapë, t'a-kam falë
Mund të pish gjaknë t'im sot
Po zëmërn' s'm'a urdhron dot.
Mos ushqe të tillë shpresë
Të.....

MURATI

Ahere lë re të vdesë,
Edhe më qaf'e-paç vetë
Si këtu dhe nd'atë jetë,
Se fajnë ndë këtë punë
E ke ti nuk'e kam unë

MAMICA

Im vëlla vete ndë qiell,
Tek dotë ndrijë si diell
Ati shpyrti dot'i-dalë
Po lë pas shumë të gjallë ;
O Murat të rënte pika
Të mos të të dalë frika
Se si u ngjall Skender-beu
Mund të h'apet prapë dheu
Dhe të ngjallet tjatër herë
Një nga vëllezret e-tjerë ;
Si Fatimea, o lumë
Shqipëria; ka gra shumë ;
Kërren trima Shqipëtarë
Që s'lënë gjaknë pa marrë
Mbase del no-një prej nesh
Të shtrin një ditë nde shesh ;
Mbase del një Shqipëtar
Të ndër një ditë ndë varr
Dhe këtë trim të vërtetë
Për burrë do-ta marr vetë.
Në mos vafsh nga njerëzia
Dot'a-gjëç nga Perëndia
Se të ligat që ke bëra
Mërzitnë botën të tërë ! (del)

## Pamj'e IV

### MURATI, MUHAMETI, FERITI, TAHIRI

MURATI

Ferit, bëre si të thashë ?

FERITI

Këtu pranë nd'od'e lashë
Dhe dy ushtarë të mirë
Ruajnë Musa vezirë
Se mos gënjenet e dalë.

MURATI (te Muhameti)

O vëlla me këto fjalë
Që flet Mamica për mua
Më shtyn t'a vras, dua, s'dua.

MUHAMETI

Thërret shan nga dëshperimi.

MURATI

Nuk i pëlqen sot Selimi
Se ka mendime të tjera.....
Po kot na mburret e mjera:
Skënder-beu kur të vdesë
Nukë dotë ketë shpresë.
Ti qënkej vëlla me besë
Muhamet, nga ti sot s'presë
Armiknë të ma tregoje
Se pandejë se s'më dojë.

MUHAMETI

Gjaku s'bënet ujë kurrë.

MURATI

Gjete Skënder-bej gjaurë
Dhe m'a-dhe me dorë vetë!
Ti qënkej mik i-vërtetë:
Rrëfemë sot, paç uratë.
Si tj'a-bëj?

MUHAMETI

Jeta t'u-ngjatë
Të till'arrmik të vërtetë
S'bën t'a-lësh ndë këtë jetë:
Bota nuk e-ka dhe parë
Dhe u-ngrenë si të marrë
Po si-kur t'a-lësh të gjallë?
Jo, vëlla jo! me një fjalë.
Vdekj'e-ti t'është detyrë.

MURATI

Po si t'a-vdes, me ç'menyrë?
Çfaqur, jashtë, fshehur, mbrënda

MUHAMETI

Mua, vëlla, m'a-ka ënda
Dhe gjëj për mir'e-për mbarë
Jashtë t'i-vëmë litarë....
Gjithë t'a-shonë të vdesë
Për-të të mos kenë shpresë.

MURATI

Që të mos bënet trazirë
Më duket është më mirë
T'a-vrasim këtu tek jemi
Pastaj të dalim të themi....

MUHAMETI

Janë mendime të kotta
Se nukë na beson bota
Dhe po të mos na besojnë
Shqipëtarët e- kërkojnë
Dotë thonë: na gënjeu
Mbreti, se rron Skënder-beu.

Po të vritet si them unë
Zot, nukë na gjan kjo punë
Se pa vdekur do të thotë
Përpara ndë gjithë botë:
» Jam, jam vërtet Skënder-beu!

MURATI

Rrofsh e qofsh, Muhamet ngreu
Ecë të bësh si më thua
Se ti qënkej mik për mua
Ngreu vëlla mblidh ushtarët
Miqtë që ke dhe të parët
Dhe Tahirë merrë pas
Bëj c'të duash ndë pallas;
Sot këtu je satrazem.
Esht'e tepër të të them
Që të març masa të mira
Të mos na gjajnë trazira.
Mos harro, ashtu më rruash
Sultanë vetë t'a ruash
E- ke mik, e-ke vëlla

MUHAMETI

Ndë derë
Ushtarët sot nuk'i-kemi ?
Dotë bëjnë si t'u themi,
Të na mbaronet qëllimi.

TAHIRI

Yti mbaronet, po imi ?
Dotë punosh si më the ?
Dotë mbaç benë që dhe ?

MUHAMETI

Po të dish të më ndish mirë
Sot, do të t'a fal vezirë
Tahir, mos u-bën i-marrë
Puna do të vejë mbarë
Po të bësh c'duetë bërë
Me trimat e tu të tërë.
Mos mendo bota se ç'thotë
Se s'ësht'e dreqtë kjo botë
Po ngreu Tahir të shkojmë
Sot për neve të punojmë;
Sa-do, sa-do, për të tjerë
Punove more i-mjerë.
Në do të jesh. sadrazem
Më të dashur se ty s'kam;
Vëlla për këtë shërbim
dotë të lë ndë vënd t'im,
(del me Feritnë)

## Pamj'e V

## MUHAMETI, TAHIRI

MUHAMETI

Mik, qëllimi m'u mbarua
Se munt të bëj si të dua
Fuqinë sot e-kam unë.

TAHIRI

O Zot të pëlqen kjo dhunë?
Mendoju se tradhëtorë

Bota s'e-nderon.

MUHAMETI

Ndë dorë
Ushtarët sot nuk'i-kemi ?
Dotë bëjnë si t'u themi
Tahir, puno si të them

TAHIRI

Si-do q'është pun'e-ndytë
Dotë bëj si-kur mbyll sytë
Po dhe ti të sillesh mirë
Mos ngasë njeri vezirë
Dhe Mamicën : Sa të rroj
Zot, nga ti dot'i kërkoj.
Shi se mos m'a-besh me dhunë

MUHAMETI

Nukë ke besë tek unë ?

## Pun'e-Katërtë

### Pamj'e I

### SELIMI, ZADEA

ZADEA

E pe ç'bëri Muhameti ?

SELIMI

Një gjëm'e-madhe të gjeti :
Për jot'ëmë s'mbeti shpresë
Se Murati dot'a-vdesë.
Moj, mike për këtë punë
Nuk e shpëtoj dot as unë
Po s'më vjen keq për jot'emë
Që pësoi këtë gjëmë :
Ajo sot u-tradhëtua
Se më tradhëtoi mua.
Kur jam, me fuqi të Zotit,
Un'i bir'i Kastriotit
Këtë kur e-di fort mirë
Pse të thotë për vezirë
Q'është vetë Skënder-beu ?
Pse, pse, jot'ëmë gënjeu ?
Këtë gjë të pa besuar
Pse sot e dha me të shkruar ?
Mike, me këto të rrëme
Jot'ëmë bën dy llagëme :
Më bën të bir'e Muratit
Më vjedh ëmrin e t'im'atit
Më shet gjaknë nga kam lerë
Dhe sot e-fal ndë të tjerë
Këtë nder ja merr të birit
Dhe ja fal Musa vezirit
Që të vdesë ky për mua !
Të tillë shërbim s'e-dua
Nuk'e-pëlqej këtë dhunë
Se Skënder-beu jam unë.

ZADEA

Zot, qaej nga mëma ime
Se u duk sot kaqë trime
Po sot ësht'e dyta herë

Që të shpëton mor i-mjërë.
Nga frika mos tradhëtonesh
Nga frika se mos trazonesh
Prapë kjo gënjeu mbretnë
Se kandisi Muhametnë
Me një gënjeshtër të shkruar;
Kjo të paska tradhëtuar?
Zot, Murati egërsirë
Zuri sot Musa vezirë
Dhe pa ditur q'e-ka djalë
Sot s'do t'a lërë të gjallë.
Të mos ish bërë kjo punë
Dotë jeshe sot këtunë?
Të lutem të më ndegjosh
Ti sot duet që të rrosh
Se të kërkon Shqipëria.

SELIMI

Sot të verbon dashuria
Mikë, ndaj ke këtë shpresë
Të lë një tjatër të vdesë
Për mua! Nukë jam shtazë;
Murati kur do të vrasë
Të birrë për Skënder-benë
Dotë vete të gjëj mbrenë
Dhe.....

ZADEA

Zot, s'të thashë për Sultanë
Të vrasë vezir Musanë
Po s'dua të vritesh tinë
Se lipsej për Shqipërinë
Musën, Selimn'e-vërtetë
Në do t'a-shpëtosh ndë jetë
Ndalo Sultanë më mirë
Mos le të vrasë të birrë
Ngreu një ditë më parë
Me miqt'e-tu Shqipëtarë
Kapto kufin e Turqisë
Bënu mbret i Shqipërisë!
Sultani kur të ndëgjojë
Dhunën dot'a-kupëtojë
Vezir Musanë, pa fjalë
Dotë shojë q'e-ka djalë
Po duet zot, të mëngosh
Se koha shkon, vete bosh;
Ngreu mik dhe duku burrë

SELIMI

Kjo punë s'bënet sot kurrë
Se Shqipëtarët ushtarë
Humpnë shpresën me të parë
Që mbreti me Muhamenë
Gjen'e-zunë Skënder-benë.
Ca nga brënga, ca nga frika
Të tërëvet u-ra pika
Dhe zjarri që kishn'u-shua.
Kur Musa shkoi për mua
Shqipëtarët sot s'quxojnë
Dhë të çfagem, s'më besojnë
Po dhe të më vënë besë
Prapë Musa mund të vdesë
Se zonjë, Sultan Murati
Dot'marroset nga inati

Për vdekij dot'a-gjukojë
Nga frika se mos shpëtojë
Dot'a-vrasë me të parë
Pastaj kokën dot'i-marre
Dhe t'a-tregojë ndë botë!
Jo këtë gjëme të ndotë
Nuk mund t'a-duroj kurrë.
Zade, një të tillë burrë
Kërkon sot të gjëç tek nuë?
Të rroj me turp e me dhunë!
Ketë tmer s'e-duron Zoti
As im at' Jan Kastrioti.
Murati, kjo egërsirë
Kërkon mua jo të birrë;
Vezirë s'e do të gjallë
Se nukë di q'e-ka djalë.
Mos më ndalo të nderonem
Dhe të vete të tregonem
T'a-vras, apo të më vrasë!
S' dua njeri të më flasë
Ndryshe... C'do këtu Murati
Dhe Muhameti lugati?

## Pamj'e-II

### Selimi, Zadea, Murati, Mohameti, Ushatrë

MURATI (Ushtarëvet)

Zini këtë dosë, zini
Mirnje jashtë, mos e-lini
T'ikij vetëm pastë nëmë?

(te ZADEA)

Ku është fsheur jot'ëmë?

ZADEA

Nuk'e di zot.

SELIMI (te Murati)

Ç'faj ka bërë?

MURATI

Dot'a-msosh nga ne të tërë
Shkakn'e-këti zëmerimi.

ZEDEA (te Murati, duke ikur)

Mos beso ç'thotë Selimi
Nuk'është fjal'e vërtetë...

MURATI

Çporru se unë'-di vetë
Nukë pres mëndje nga gratë
(dy ushtarë marrën Zadene)

## Pamj'e III

### MURATI, SELIMI, MUHAMETI, USHTARË

MURATI (te Selimi)

E msove bir, paç uratë?
C'të thoshte tani Zadea?
E-pe ç'bëri Fatimea?
Bir, kjo bushtrë me gënjeu

Musa qënka Skënder-beu!
Selim, e-di q'e ke mik
Po ay sot ësht'armik
Eshtë princ'i Shqipërisë
Armik i gjithë Turqisë
Armik për ty dhe për mua
Besë-qëni. prandaj dua
T'a-ther t'i pi gjaknë vetë
Dhe t'a-dërgoj nd'atë jetë.
Selim, pse pushon, pse s'flet?

SELIMI

Ndëgjo, të lutem o mbret
T'ishte veziri këtunë
dojë të flasë dhe unë'
Për gjithë këto te gjara

MURATI (ushtarevet)

Sillmani këtu përpara
Të shukojmë ç'do të flasë.

## Panj'e-IV

### Murati, Selimi, Muhameti, Musa, Ushtarë

MURATI

Selim, ky do të më vrasë?
Duket'e-ka për lëvdim
Se nuk ka frik'as ndrim.
E-she Selim, paç uratë
Ndë ç'rrezik gjëndet yt at?
Të mos qënkej Muhameti
Selimi pa baba mbeti
Po desh Zoti dhe shpëtova
U-habiçë kur ndëgjova
Bir, Zadenë të më thotë
Të mos të të besoj....

SELIMI

Kottë
Tha Zadea këtë fjalë

MURATI

Bir, mbase të qante hallë
Folë Selim paç uratë
Se pa ty, s'bën gjë yt atë
Mos msove sot tjatër punë?

SELIMI

Zot, vërtet msova një dhunë
Që të punon Fatimea
Si më tha tani Zadea
Të gatit të madhe gjëmë.
Mos pande që s'e kam mëmë
Nnaj.....

MURATI

Bir, të njo, këto gjëra
Ti nuk'i-vë re të tëra
Po c'janë këto llagëme
Që bën ajo?

SELIMI

Me të rrëme
Zot, t'a-ka me të pa-besë...

MURATI

Besë-qënja, dotë vdesë

SELIMI

Gjithë këto të këqia
S'i-duron as Perëndia.
Mundo zot, mundo të liqtë
Dhe duaj e ndero miqtë
Skëndër-beu është'armik
Dhe për ty s'bënet m'i lik;
Ndaj të lutem t'a mundosh
N'atë jetë t'a-dërgosh.

MURATI

Të lumtë goja Selim
Se ndyshe s'kemi shpëtim;
Skënder beu dotë vdesë.

MUSA (te Selimi)

Unë sot s'kam tjatër shpresë
Po këto fjalë, s'i-presë
Nga goja jote, Selim
Të keshë njojtur për trim
Zëmër-gjer'e me dëshirë....

SELIMI

Sot dotë më njosh më mirë.
Sultan hap syt'e shukomë;
Ti vezir Musa, ndëgjomë
Nuk e fshej sot të vërtetën
Se pa nder s'e dua jetën;
Murat, me fuqi të Zotit
Jam i bir'i Kastriotit
Do me thënë me një fjalë
Musën vezir'e ke djalë.

MUSA

Selim ç'fole?

MURATI

Je i-kruar!

SELIMI

Ini të dy të verbuar.

MURATI

Këto të msoi Zadea?

SELIMI

Zot, të gënjen Fatimea

MURATI

Të ka marrë koka erë.....

SELIMI

Zot, kjo është'e-dyta herë
Që të gënjen.

MURATI

Je i-marrë!

SELIMI

Zot ndëgjo se-si ka gjarë
Skënder benë kur t'a muarr
Kjo zonjë të pru ndë duar
Një djalë qi k'ish të sajnë
(Dhe sot për të, syt'i qajnë)
Pandeve, kur e mbulove
Nga Kastrioti shpëtove
Po kjo e rriti ndë jetë
Si kur e kish pjellë vetë.
Kur e more ndë pallas
Të pruri dhe këtë pas
Për hatër të kësaj mike
Që t'u-duk shumë besnike
Këtë cun që kishte vetë
E-deshe me të vërtetë
Se pandeje, besa-besë
Q'ish i-bir'i Fatimesë
Musa. Zot, kur u-largove
Kur vajte jasht'e lëftove
Kur u nise për Axhem
Le të shoqen me dy djem
Do-me-thenë ca më mirë
Me mua dhe me t'yt birrë
Selimnë Jeshmë vërsnikë
Ndaj jot shoqe s'pati frikë
Të vuri, prandaj e-dua
Ndë vënd të Selimit, mua
Dhe Selimnë ndë vënd t'im.
Për të mos pasur dyshim
Nga Murati të shpëtoj
Një ditë të mbretëroj
Këtu dhe në shqipëri
Ndë fron që ke zenë ti.
Zot, kur u-ktheve këtunë
Pas tre vjet u bë kjo punë.
S'të vate mëndja për dhunë:
Foshnjë Musa. foshnjë unë;
Ishim rritur si binjakë
Mbase që gjanim dhe pakë
Zot, Fatimen'e besove
Këmbimnë s'e-kupëtove
Ndaj më more për Selimnë
Dhe Musa vezirë trimnë
E-more, zot, besa-besë
Për djalën e-Fatimesë
Që there me dorë vetë
Dhe s'gjëndet ndë këtë jetë.
Murat. ngjer tani u-fsheva
Si jot shoqe të gënjeva
Se ushqejë tjatër shpresë...
Po sot s'mund të lë të vdësë
Ay që desh vdiq për mua!
Zot, këtë tmer nuk'e-dua.
Të lutem ea ndër mënde
Mos e vre me dorë t'ënde
Ky gjak sot s'bën që të rjedhe
Emrin t'im deshi të vjedhë
Emr'i-ti është'i pa faj;
Për Skënder-bej mos e-mbaj

Hap syt'e shukoe mirë
Zot, nukë nje dot të birrë ?
Vrae, there Skënder trimnë,
Po shpëto, kurce Selimnë,
Atë që më ka shpëtuar.

MUSA (te Murati)

Shukon, mor i-mallëkuar
Ç'djalë të ka falur Zoti ?
Të mos jeshë Kastrioti
Dojë të jeshë Selimi,
Zëmër-madhi, burrë trimi,
Që nukë ka shok të dytë.
E-shukon të plaçin sytë,
Ndëgjove se me ç'përrallë
Do të më lërë të gjallë ?

(te SELIMI)

Mjaft Selim, vëlla, mjaft rende
Të priç vetëhenë t' ëndë
Sado me këto gënjeshtra
Më drodhe mishtë me eshtra
Se Murati s'të beson
Gënjeshtrat i-kupëton
Të shpëtova, si the vetë
Një dit'e të dhashë jetë
Po zot, për këto shërbime
S'e-humba jetënë t'ime
Po ti, me fjalët që thua
Sot kërkon të vdeç për mua !
O Selim, të qofsha falë
Le me nj'anë këto fjalë
Mos kërko të më març nderë
Edhe gjakne nga kam lerë ;
S'tështë sado mbretëria ?
Nukë t'është mjaft Turqia ?
Mik, te kjo bot'e veshtirë
Nukë kam tjatër dëshirë
Të vdes princ i-Shqipërisë
Të rroç sultan'i Turqisë.

MURATI

Të dy dreqi sot u-Martë !
E-humba me këtë qartë....
Mohamet, vëlla me besë
Për cinë sot të kem shpresë
Kush më thotë të vërtetën ?
Cilit sot t'i-këput jetën ?
Cili është Skënder-beu ?

MUHAMETI

Sultana kur i-këmbeu
Nukë diet e vërteta.

SELIMI

Bënen katrë vjet q'e-gjeta
Nukë kini kupëtuar
Pse s'desha për të martuar
Me Mamicën e-bekuar ?
Se Fatimea më tha
Që jemi motr'e vëlla.

MUSA

Fatimea ?

SELIMI

Vetë dora;
Mamicën pandaj s'e-mora
Se besova Fatimenë

MUSA (te Murati)

Zot, Selimi do Zadenë
Të bijën e Fatimesë
Se kjo me këtë martesë
Zot, kërkon e ka dëshirë
Të bëjë dhëndërr t'yt birrë
Se Selimi po të rrojë
Pas ty mund të mbretërojë

MURATI

Muhamet, c'është kjo grua?
Gënjen Selimnë si mua.
Po tani ku dot'më vejë?

MUHAMETI

Mund dhe të mos e-gënjejë.

TAHIRI

Me punëra që ka tërë....

MUHAMETI

Sot'ja gënjen më të bërë
Ja po.. s'di ç'të them as unë.

MURATI

Esht'e-keqe, na hap punë.

MUHAMETI

Mbase nuk'e-ka me dhune.

MURATI

Këto lodra, këto gjëra?

MUHAMETI

Mbase s'i bëri të tëra.

MURATI

Më ka gënjyer për hera
Më dha të birr'e ja thera!
Dhe lashë ndë këtë jetë....

MUHAMETI

Mbase nuk'ësht'e vërtetë

MURATI

Po kjo bujë kjo trazirë?

MUHAMETI

Zot, mbase na del për mirë.

MURATI

Skënder-benë nuk'e-fsheu?

MUHAMETI

Zot, mbase nuk'e-këmbeu.

MURATI

Po kush është djali im?

MUHAMETI

Një nga të dy, s'ka dyshim.

MURATI

Me këto mëndje të ndara
Nukë di ç'të bëj përpara
Qysh të shpëtoj nga kjo dhunë?

MUHAMETI

Sot mbase të shpetoj unë....

MURATI

Një djalë nga këta dua
Dy janë shumë për mua
Dhe më vjen sot të pelcas
Se s'di se cinë të vras
Që të shpëtoj vetëhenë!

MUHAMITI

Zot, s'e-njojnë Skënder-benë.

SELIMI (te Murati)

Të lutem, mos ki dyshim
Unë jam.....

MUSA

S'je ti Selim;
Me fuqi të Perëndisë
Sot jam princ i-Shqiperisë.

SELIMI

Jo mik, mos m'a bën me dhunë
Nukë je ti se jam unë.
Të lutem mos u-mundo
Lemë të vdes në më do.

MUSA

Pa faj s'të dërgoj ndë varr
Selim, së jam Shqipëtar
Ti je i bir'i Sultanit.

SELIMI

Unë jam i bir'i Janit
Le ket'ëmër që të vret
Dhe merr t'ëndë të jesh mbret.

MUSA

Këtë mbretëri s'e-dua
Eshtë për ty jo për mua;
Fatimea, me këtë ëndërr
Kërkon të të bëjë dhëndërr
Rro mik se të do Zadea.

SELIMI

Ty, të shtyti Fatimea
Të duash e të març grua
Mamicën, se je nga sua
Se je i-bir'i Sultanit.
Të jeshe ti djal'i-Janit
Fatimea Shqipëtare
Nukë do të duaj fare

Më të motrën të martonesh
Të ndyresh e të ç'nderonesh
Mbreti kur deshi për mua
Të m'apë Mamicën-grua
Ç'bëri Fatimea trime
Për të prurë pak ndalime ?
Nga frika se mos e-dua
Dhe marr motrën t'ime grua
Me rrëfeu se ç'e-kam
Më tregoi cili jam
Kshtu martesën e ndaloi
Dhe nga tmeri na shpëtoi.
Nga frika se mos më njojnë
Për Skënder-bej më tregojnë
Nga frika se mos më zënë
Fatimea si një nënë
Çpejto thirri Muhamenë
Dhe të dha për Skënder-benë ;
Ndaj sot, zune ty për mua
Këtë qëllim kish kjo grua ;
Bëri prapë tjatër dhunë
Vetëm që të shpëtoj unë.
Murati, kjo kishte shpresë
Nga dora jote të vdesë
Që të paguaj kjo dhelpër
Gjaknë që derth më të tepër.
Atë që kërkon kjo trimë
Eshtë, mik, detyra ime.
Doje të vrasë Sultanë !
Bënë mirë që s'të lanë
Se s'vret i biri babanë
As babai vret të birrë
Se është pun'e-vështirë.
Gjakn'-Kastriotit gjorë
Dotë rend t'a-marr me dorë
Se jam Skënder-beu vetë
Ti je Selim'i vërtetë.

MURATI

O Zot, c'është kshtu me mua!
Kë të vras e kë të dua ?
Cili nga këta s'do t'anë
Se të dy armik më kanë !
Një prej ta më ka baba
Po kush është nga këta ?
Një nga të dy sot ësht'imi
Po cili është Selimi ?
Mir' ay që s'më tregon
Po zëmra pse s'm'a dëfton ?
Kur thërres : Selim ! Selim !
Rrinë të dy ndë qetim
Po të thërres : Skënder-be
Nga të dy vallë kush je ?
Më përgjigjen që të dy
Dhe s'më shonë dot me sy !
Nga këta djem me një fjalë
Dy armiq kam, as një djalë !
O bir, cili-do që je
Mirë për baba s'më nje
Se kam bërë të këqia
Po s'të pëlqen mbretëria ?
Mirë qe s'e do babanë
Po nukë nderon Sultanë
Sultan'e gjithë Turqisë ?

O ti, mbret i Shqipërisë
Që ke vdekur dhe je tretur
Dy djem të paskanë mbetur !
Dhe që të dy të nderojnë
Dhe të vdekur të kerkojnë
Dhe s'gjëj as një të më dojë
Pas meje të mbretërojë !
Ng'ajo jetë ku ke vatë
Rrëfe, rrëfe. paç uratë
Rrëfemë, të qiofsha falë
Cinë nga këta kam djalë
Që t'a dua, t'a-nderoj,
Dhe tjatrin të t'a-dergoj.....
Se ç'mendoj e ç'jam i-marrë !
Të dy janë gënjeshtarë.
Kur këta s'duan sot mua,
Unë përse dot'i-dua ?
Kur as një baba s'më ka
Pse mendonem si baba ?
Zot i-math të qofsha falë
Pse më do baba pa djalë ?
Zot i-math mos më mundo,
Po rrëfema që t'a-njo,
Ndryshe të dy dot'i-vras,
Të mos mbetet as një pas.

## Panj'e-V.

## MURATI, SFLIMI, MUSA, MUHAMETI, FERITI, FATIMEA, USHTARË.

FERITI

O Sultan, t'u-ngjatë jeta,
Fatimenë tek e-gjeta
Dhe tek e-solla këtunë.

MURATI (te Fatimea)

Moj bushtrë, ç'është kjo punë ?

MUSA

Folë, zonjë të jam falë,
Dhe shuko mos ndërroç fjalë

SELIMI

Folë, zonjë të vërtetën
Se nuk'e-dua sot jetën
Folë mos u tremb për mua

FATIMEA

Bir, ç'janë këto që thua ?

MURATI (te Fatimea)

Mos u-shtir si-kur s'ndëgjon
Mos bën si-kur s'kupëton
Se s'të shukoj dot me sy.
Cili nga këta të dy
Eshtë Selim'i vërtetë ?
Folë !

FATIMEA

Pse nuk'e-gjën vetë ?

SELIMI

Zonjë, Musa e-gënjeu

Tohtë q'është Skënder-beu.
Po.....

MUSA

Këtë nder të pa çmuar
Zonjë m'a-dhe sot të shkruar.

MURATI (te Fatimea)

Të maratë djalli, të martë
Folë, ndae këtë qartë.
Të vaftë shpyrti ndë ferra...
Vërtet më ke lën'ethera.
Djalën t'ënd për Skënder benë!
Vërtet gënjeve me mbrenë?

FATIMEA

Sa do fole, sa do shave
Se vërtet djalën t'im vrave;
Skënder beu është'i gjallë.

MURATI

Cinë nga këta kam djalë?
Me njeri-jetrin qërtojnë
Dhe s'duan të më tregojnë
Po ti?

FATIMEA

As ky, as ai
Të vërtetën nuk'e-di
Prandaj as një nga këta
Nukë të një për baba.

MURATI

Dosë, nukë ke shpëtim
Po s'tregove tjalën t'im.

FATIMEA

Mos më thuaj t'a rrëfej
Se prapë dot'të gënjej:
Me ty njëzet vjet këtunë
Kam vuar për këtë punë
Dhe që s'më more dot vesh
Sot, ti qan, e unë qesh
Se njeri nga këta djem
Esht' yti, po sot s't'a-them
Të keqe s'guxon t'u-bësh
Kë të vraç e kë të lësh?
Si-do që je egërsirë
Ke frikë mos vraç tët birrë;
Ndruan, trëmbej, me një fjalë
Mos lësh armiknë të gjallë
Dhe unë prandaj besoj
Sot që ty t'i-shpëtoj

MURATI

Po n'i-vrafsha që të dy
Moj bushtrë, bashkë me ty?

FATIMEA

Unë këtë dëshiroj
Këtë pres këtë kërkoj
Që t'i-bësh djalit yt varrë!
Bënia, një ditë më parë

Bënjia o qën i-pa besë
Të shoç djalën t'ënd të vdesë!
Vrae, për ëmër të Zotit
Të marr gjakn'e-Kastriotit
Me dorën t'ënde të ndytë
Dhe pastaj le të mbyll sytë

MURATI

Moj nepërkë moj kucedrë
Që s'paske gjak, turp as sedrë
Unë të dojë me besë
Të mbarova shumë shpresë
Të mora të darovita
Dhe ndë fron t'im lart të ngrita
Dhe mbretëreshë të bera!
Sot i-harove të tëra
Sa Dhe të birrë m'a-more
Dhe nga zëmr'e-ti më nxore
Sa kërkon të vritet vetë
Për baba të mos më ketë?
Me një dashuri të rreme
Më ke pumuar llagëme
Dhe sot më lë ndë dyshim
S'më tregon Selimnë t'im!
Besë-qënia me të shara
Guxon e më del përpara
Kjo Shqipëtark'e pa-besë
Mohamet, sot dotë vdesë!

MUHAMETI

Të lutem mbaj zëmërimnë
Se nukë dimë Selimnë;
Sultana duet të rrojë
Ngjer-sa të na i-tregojë
Ndryshe venë dëm të tëra
Zot, dobitë që të bëra
Le tani t'i shkoj'inati
Atë që s'bën dot Murati
Mund t'a bëjë Muhameti
Se punë t'jatër s'më mbeti
I kë zot dhe lemë mua
Pak vetëm me këtë grua
T'i flas t'i-xbut zëmërimnë
Të më rrëfejë Selimnë
Pas taj bën ç'të duash vetë
Me Skënder-ben'e vërtetë.

MURATI

Vëlla me këto kuvede
me kënaqe dhe me dënde
Shuko mik ashtu më rruash
Binde foli si të duash
Më të keq e me të mirrë.
Sa të tregojë t'im birrë.
Mik, ti rri me këtë grua
Ju të gjith'eni me mua.

(del)

## Pamj'e-VI

## MUHAMETI, FATIMEA

MUHAMETI

Zonjë, gjith'u ngren'e vanë

Dhe këtu vetëm na lanë ;
Pa fikë të kuvëndojmë
Njeri-jetrin të besojmë.
Ndëgjo, zonjë, ç'qëllim kam
Se tradhëtor për ty s'jam
Ndëgjo, bënu zëmër-gjerë
Ti në mos e-do një-herë
Sultan'as unë s'e-dua
Dhe.....

FATIMEA

Tani s'qesh dot me mua.
Fat-zeza s'të kupëtova
Pësova se të besova

MUHAMETI

Nukë pësove gjë kurrë

FATIMEA

Ti s'paske fjalë si burrë
Ti s'je njeri për të qënë
Fjalën që më keshe dhënë...

MUHAMETI

Zonjë, s'të dolla nga fjala
Po ndëgjo.....

FATIMEA

Janë përralla :
Me Muratnë vajte fole
Dhe thuaj nga fjala s'dolle ?
Po ç'kupëtove, c'fitove
Që vajte më tradhëtove ?

MUHAMETI

U-bëshe mik me Sultanë
Ndryshe s'i vejë dot pranë ;
Mos pande se të gënjej...

FATIMEA

Atë që duet pandej
Po lei fjalët më nj'anë,
Eçë tallu me Sultanë,
Se unë nukë të njo.

MUHAMETI

Kur s'më një mos më gjuko;
Si ka thënë një, një-herë,
Ndëgjomë pastaj më bjerë.
Murati ruej nga unë
Se mos ja punoj me dhumë,
Se mos e-vras t'i-marr fronë
(s'ish i gënjyer për Zonë)
Tani zonjë, gjeta konë
T'a sho dhe t'i flas pa ndim
Të mbaroj qëllimnë t'im.
Për të vrare s'keshë shpresë
Se ka pas trima më besë :
Kush mund të vrasë Sultanë
Që mban dit'e natë pranë
Tre, katrë-qind Shqipëtarë
Gjithë trima kordhëtarë ?
Një ditë miqtë më thanë :

Në do të shkelmosh Sultanë
Dhe Sultan të bënesh vetë
Duet të mos rriç i-qetë.
Murati ka sot dëshirë
Të vërë ndë fron të birrë;
Në do të nderosh zakonë
Në do të mos humbaç fronë
Tundu, Zoti të të ndijë
Pa le të vijë ç'të vijë
Kur ndëgjova këto fjalë
S'u-vura veshnë ndë ballë
Po një ditë ndaj të gdhirë
Kjo mëndje m'u duk e-mirë
Që të vejë puna mbarë
Shqipëtarët duan ndarë
Thashë dhe ndë Shqipëri
Dërgova ca miq të mi
Dhe një dit'u hap kjo fjalë:
Skënder-beu është'-gjallë?
Ndë Shqipëri e-besuan
Po këtu të tërë ndruan
Ata që ruajn Sultanë
Besë të kjo fjalë s'dhanë
Se Tahiri q'i-urdhronte
Nukë donte të besonte.
Ahere ndë dhomë t'ënde
Erdha që të blej kuvënde
Dhe msova nga goja jote
Fjalët që më the zotrote.
Këtë lajm'e-hapa vetë
Po qënka fjal'e-vërtetë.
Sultan'ahere kërkova
Fjalët që the ja tregova,
Me shpresë se kjo trazirë
Do te na dalë për mirë.
Mberti, kur e pa të shkruar
Më pushtoi me dy duar.
Dhe mbronjës i-ti Tahiri
Burrë trimi, zëmër-miri
Kur e-msoi u gëzua
Ndë zëmer po s'u tregua;
Bën si kur nukë me she
Po sot punon ndënë dhe
Se më duket i pëlqeu
Q'u ngjall prapë Skënder beu
Nukë di sot, çqëllim ka
Po duket është me na
Dhe ka me neve një shpresë.
Skënder-beu të mos vdesë.
Murati te ky ka besë
Sot ka besë dhe për mua
Dhe mund të bëj si të dua
Zonjë, sot mund të vras mbrenë
Dhe të shpëtoj Skënder-benë;
Ndaj të lutem m'a trego
T'a shpetoj.

FATIMEA

Mos u mundo!
Me këto fjalë të rreme
Ti bën të tjera llagëme;
Ti kërkon. o egërsirë
Të vraç t'anë me të birrë
Të vraç Muratinë me djalë

Të mbretërosh.....

MUHAMETI

Janë fjalë.

FATIMEA

Kush s'ta kupëton qëllimnë?
Ti do të gjëç dhe Selimnë
Që t'i biësh me një thikë
Dhe të mbretërosh pa frikë

MUHAMETI

Zonjë, për ty sot jam mik.

FATIMEA

Qënkej shumë burr'i-lik!
Tradhëtor të them pusho
Dhe ikë se s'të sho do!.....

MUHAMETI

Mirë, mirë, sot u-chmende;
Mos m'a trego mëndjen t'ënde.
Pas këto fjal'e-guxime
Di dhe unë punën t'imë
Dotë më shoç cili jam.
Mos harro fjalët që tham
Dhe që të mendonesh mirë,
Rri ndë budrum...Sho Tahirë.

## Panj'e-VII.

### MUHAMETI, FATIMEA, TAHIRI

TAHIRI

Im zot të dërgon të falë,—
Dotë të thotë një fjalë—

MUHAMETI

Vete. Ti në do Sultanë,
Fatimenë mbae pranë,
Këtu daet të qëndrojë,
Mos ikij e na shpëtojë,
Mos na bëjë nonjë dhunë.

TAHIRI

Mos ki frikë kur jam unë.

## Pamj'e-VIII

### FATIMEA, TAHIRI

TAHIRI

Vërtet rron sot Skënder-beu?

FATIMEA

Shqipëtar pse s'hapet dheu,
Të të mbulojë të gjallë?
Dhe ti kërkon të març fjalë
Nga unë si Muhameti,
Që të tradhëtosh te mbreti

Skënder-benë Shqipëtarë !

TAHIRI

Zonjë, ndëgjomë më parë :
Vërtet sot shërbej Sultanë
Po nuk'e harrova Janë.
Prandaj kur u- hap kjo fjalë :
« Skënder-beu ësht'i-gjallë »
Sido që nuk'u besua
Mëndja sot m'u-trumbullua;
Kupëtova një dëshirë
Që s'e-çquajë dot mirë.
Sot ndë mëngjes, Muhameti
Ndë këtë dyshim më gjeti.
Për qëllim që ka të fshetë
Ka nevojë të më ketë
Se pa trimat shqipëtarë
Muratit s'i-bën dot varrë
Nukë më tha fjalë tjetrë
Po më rrëfeu një letrë
Këtë letrë kur e-pashë
Muhametit bes'i-dhashë
Po më dha përpara besë
Skënder-beu të mos vdesë.
Puna, si do që të vijë
Po t'i-ndi dotë më ndijë
Skënder-beu të shpëtojë.
Për Shqipëri të punojë
Vertet më dha këtë fjalë
Po nga fjala mund të dalë
Kur të bënet Sultan vetë
Mund të kthejë tjatër fletë :
Murati s'do Skënder-trimnë
Muhameti s'do Selimnë ;
Të dy janë ndë rrezik.
Prandaj të lutem si mik
Te më tregosh Skënder-benë
Zoti të faltë shëndenë
Mos u-tremb, s'të tradhëtoj.

FATIMEA

Tahir, nukë të besoj :
Ti ke njëzet vjet me mbrenë
Ti tradhëtove atdhenë ;
Nuk do tradhëtosh mua ?

TAHIRI

Zonjë, mëmëdhen'e dua
Kurrë s'më ka për të dalë
Nga mëndja, sa jam i gjallë.
Zonjë, për ty ç'nukë thanë
Kur more burrë Sultanë ?
Shqipëtarët që s'të njojnë
Dhe tani të mallëkojnë
Njëzet vjet ti s'ke këtunë ?
Mbase si ti jam dhe unë ;
Mbase këtu më pru Zoti
Që të rrojë Kastrioti.
Zonjë, n'e-shpëtove vetë
N'është kjo fjal'e-vërtetë
Mos e-le sot që të vdesë !
Sultani nukë ka besë :

Si e-di vetë, Murati
Mund të vrasë nga inati
Selimn'e Musa vezirë.
Të lutem beso Tahirë
Tregoi të faltë Zoti
Cili është Kastrioti
Zonjë, nga unë mos ndruaj
Po rrëfema që t'a ruaj

FATIMEA

Që t'a-tradhëtosh te mbreti
Si bëri dhe Muhameti!

TAHIRI

Të dojë t'a-tradhetojë
Të mos dojë t'a-shpëtojë
Zonjë, dotë gjëjë mbrenë
T'i-trëgojë Skënder-benë;
E njo mirë ...

FATIMEA

Po t'a-njoje,
S'ka dyshim, dot'a-tregoje.
O Tahir zëmër-lëtyrë,
Me një të tillë menyrë
Nukë më kërren dot fjalë.

TAHIRI

Mos me shaj, ndëgjo ndë ballë:
Ne vafsha të gjëj Sultanë
Dhe t'i-them t'i-hapij kranë
Kran'e-djathtë, ç'do të shojë?

FATIMEA

T'u-thaftë gjua ndë gojë!
Qysh e-di? kush të ka thënë?

TAHIRI

Shum'e dinë ndë vënd t'ënë:
Zonjë, që ditën që leu
Ndë Shqipëri Skënder-beu
Thanë që kish, past'uratë
Ndë kra një shënjë si shpatë
Eshtë vërtet a po qesh?

FATIMEA

Push?! ka dhe muri vesh...
Të kepen Tahir, mos thuash
Muratit .....

TAHIRI

Zonjë më rruash
Mos u-trëmb! kurrë kjo fjalë
Nga unë s'ka për të dalë.

FATIMEA

Mos Tahir, Zoti të faltë
Mos Tahir, tu bëfsha baltë
Mos tradhëto Skënder-benë
Të lutem kujto atdhenë;
Mos Tahir, të kam vëlla
Mos e bën këtë hata!
Tahir, ti je shqipëtar,
Nukë je Turk e barbar;

Tahir, mbroje, duaj mbrenë,
Po mos tradhëto atdhenë;
Tahir, vëndi tek ke lerë
Ka nevojë për skënderë;
Të lutem mos u-bën shkak
Të derdhet i-tillë gjak.
Fat-zeza, ç fjalë ndëgjova!
Njëzet vjet kot u-mundova,
Njëzet vjet punët që bëra
Dotë venë dëm të tëra!
Tahir, kam ndërruar besë,
Lashë djalën t'im të vdesë
Dhe vura turpin më nj'anë
Të mund të gënjej Sultanë;
Sot që desh mbarova punë
Sot.....

TAHIRI

Mos ki frikë sot nga unë,
Sot s'të vete dëm mundimi,
Dot'të mbaronet qëllimi:
Vërtet sot shërbej Turqinë
Po dëshiroj Shqipërinë.
Sot Sultanë mbret e-kam
Po tradhëtor nukë-jam
Dhe kur rron i bir'i-Janit
S'jam sherbëtor i-Sultanit.
Nukë dua tjatër mbret
Kur ësht'i-gjallë vërtet
Skënder-beu Kastrioti.

FATIMEA

Mos Tahir të faltë Zoti
Të lutem mos qesh me mua;
Vramë me duar të tua
Të mos e-sho kur të vdesë...

TAHIRI

Ja ku të them: besa, besë,
Si Gege, që jam, për Zone,
S'e vret njeri Kastrione
Unë gjall'e me të gjallë!

FATIMEA

Tahir të të besoj vallë?

TAHIRI

Të lutem beso Tahirë
Kemi të dy një dëshirë
Për Skënder-benë punojmë
Tregoma që t'a-shpëtojmë

FATIMEA

Më ndjë Tahir, s't'a tregoj
Të besoj dhe s'të besoj.
Me fjalën që më the parë
Po të duash bëni varrë
Eshtë ndë duar të tua
Në je vërtet sot me mua
Të lutem ndalo Sultanë
Shpëto Selimn'ë Musanë:
Njeri ësht'i-bir'i Janit

Dhe tjetri djal'i Sultanit
Sot për të dy ke detyrë
T'i shpëtosh Me ç'do mënyrë
Në je vërtet trim me besë
Lemë të kem këtë shpresë;
Le Muratnë nd'errësirë
Që të mos dijë të birrë;
O Tahir të qofsha falë
Lei sot të dy te gjallë.
Tëni ti dhe perëndia
Se mua m'u-sos fuqia
Se hoqa shumë mundime

TAHIRI

Tani nis detyra imë;
Që sot zonjë, po të rroj
Do të shoç ç'do të punoj.

## Pun'e-Pestë

### Pamj'e-I

SELIMI

Mëndja sot m'u-trumbullua
Zot i-math, urreva jetën!
Fatimea qesh me mua
Apo thotë të vërtetën?

Zot, im'at kush është vallë?
Murati mbret'i Turqisë
Apo Jani më ka djalë
Kastoriot'i Shqipërisë?

Zot i-math e i-vërtetë
Këtë dyshim nuk'e-dua
Nuk'e-dua këtë jetë
Kur nuk njo far'e sua?

Jo, jo! se zëmra më thotë
Fatimea s'më gënjeu;
Unë jam ndë këtë botë
Kastrioti Skënder-beu.

Po, jam Shqipëtar me besë
Djal'i-mbretit shqipërisë.
Pse dotë dojë të vdesë
Të jësh'i-mbretit Turqisë?

Mos u-çuditni me mua
Që nukë dua Sultanë
Këtë për baba s'e-dau
Se më ka vrarë babanë?

Nukë di ç'është kjo punë:
Për bir mbreti më tregojnë
Selimi nukë jam unë.
Për Selim më dëshërojnë!

Murat, me zëmër si hekur
Ti s'mund të jësh sot im'atë
Se t'im'at ti e-ke vdekur.
Dhe nd'atë jetë ka vatë!

Për atë më venë lotë;
Kur të sho më dridhet gjaku!
Zot, m'u-rëndua kjo jetë
Dua të vdes! Ç'është shkaku?

Ng'ajo jetë ku ke vatë
O baba, çtomë fuqinë ;
Dërgomë shpres'e uratë
Të lëftoj për Shqipërinë !

Shqipëri, Shqipëri lule
Vënd'i-bukur tek kam lerë
Ke hie të jesh fodulle
Se shumë trima ke nxjerrë !

Atdhe me male të naltë
Ti që më rrite që djalë
Dërgomë një grusht me baltë
T'a-puth të të kërrej mallë !

Ndë dhe të huaj besomë
Zëmra fort m'u-mallëngjye
Dërgomë një gur dërgomë
T'a vê jastëk ndë-në krye ?

Mëmëdhe që më dhe sisë
Bën një punë më të mirë ;
Thyej xgjedhen e-Turqisë
Të vi të të sho të lirë ?

Të mos heq e të mos vuaj
Posht'e lart e i sëmurë ;
Të mos vdës ndë dhe të huaj
Se nuk dotë tretem kurrë ?...

Ngreu moj Shqipëri ngreu
Vish armët e-Trimërisë ?
Turqia mjaft të gënjeu
Bjeri ndë kokë Turqisë ?

Zot i-math që tek do gjênde
Mos më le sot me dy mënde
Mos më le vartur ndë mes
Sot ja të rroj, ja të vdes !

Zot, ja bêmë sot të fortë
Ja po....Kërcasin ndë portë
Murati që më bën varrë.
Mbase dërgon të më marrë.

## Pamj'e-II.

## SELIMI, MAMICA

SELIMI

Ti këtu ? Jam fat-mirosh
Se më vjen të më Shukosh.
kush të dërgoi?....

MAMICA

Murati,
Sultani, turi-lugati
Më dërgon të të kandis
Të jesh një far'e-një fis
Do-më. thënë me një fjalë
Sultani të do për djalë
Se të do. thotë me ashkë
Do, të na martojë bashkë
Dhe më dërgon sot këtunë
Që të mbaroj këtë punë
Si-kur gjaku nuk më thotë
Se ç'të kam ndë këtë botë.

SELIMI

Dojë të më thosh dhe imi
Cili sot është Selimi ;
Po zëmra ime pushon
Psherëtit edhe rëkon !
Nukë di sot ç'frikë kam
Unë jam, a unë s'jam
Skënder-be ?

MAMICA

Frikë kur ke
Im vëlla dukej që s'je :
Kush ka frikë nga një varr
S' është burrë Shqipëtar ?
Një princ Shqipëtar me besë
Nukë trëmbet se mos vdesë ?

SELIMI

Unë vdekjen e kërkoj
Se po të vdes sot, shpëtoj
Shpëtoj nga këto dyshime
Kur s'di vetëhenë t'ime
Kur ëmri, nderi, për mua
Varen vetëm nga një grua
Dhe kjo grua Shqipëtare
Ndë një fjalë s'qëndron fare :
Gjërat që më tha një herë
I tha sot për njers të tjerë
Kush është sot, Skënder-beu ?
Cinë nga neve gënjeu ?

MAMICA

Zot, kur ke këtë dyshim
Nukë je vëllai im
Se ay që do të jetë
Trimëri duet të ketë.
Shuko Musa si punon
Si guxon, si kuvëndon ;
Mbreti e-sjell e përcjell
Po Musa nga mëndja s'del :
Fatimea, e gënjeu
Po thotë : jam Skënder-beu

SELIMI

Si kur them unë që s'jam ?
Vetëm një dëshirë kam :
Gjaknë që kam sot ndë zëmër
Dua t'a-derth për këtë'ëmër.
Po c'ka Murati me mua ?
Pse më do, kur nuk'e-dua ?
Pse s'më vret, a pse s'më pret
Pse më do me të vërtet ?
Pse thotë që më ka bir ?
Pse, më do me të pa-hir
Pse, pse nga kjo mëndje s'del ?
Pse vallë më përkëdhel ?
Skënder-beu kur jam unë
Pse guxon më mban këtunë ?
Kur dua gjaknë t'i marr
Pse nuk'më dërgon ndë varr ?
Kur e-shaj pse nukë flet ?
Pse do të më bëjë mbret ?

Unë mendonem t'a-vras
Ay, pse më she me gas ?
Unë kur e kam përpara
Nukë lodhem me te shara
Ay, përse më duron ?
Pse hidhet e më pushton ?
Pse nukë trëmbet nga unë ?
Si vezirë pse s'më zunë ?
Motrë, të tilla mendime
Më mbushim me hidherime
Dhe si-do që s'e-sho dot
Ndë të math dyshim jam sot.
Dua t'a-ther si një derr
Po trëmbem mos ryj ndë tmer.
Mir'e-marr e heth ndë det
Po n'është baba vërtet ?
Dua t'a-vras dhe pa shkak
Po në jemi nga një gjak ?
Motra ime, me një fjalë.
Ky dyshim më ka të gjallë.
Ti si nuë nukë je
Si ti e-di se ç'gjak ke
Ndaj duet te më ndimosh
Motrë, jo të më qërtosh.

MAMICA

Djal'i-ti sikur të jesh
Për baba s'duet t'a kesh
Dhe sa pa lar'atë gjak
Që ka derdhur, zot pa shkak
As bir'iti mund të thuesh
As Skënder-beu të quesh.

Një nga këta të dy jë :
Ja Selim, ja Skënder-be ;
Që të dy kanë detyrë
Të lajnë një gjak të ndyrë.
O vëlla kie dyshimnë
Po mos mërgo zëmërimnë ;
E-ke a s'e-ke baba
Gjaknë s'e-ke pa mardha....
Sot nukë je gjë për mua
Se unë për vëlla dua
Atë trim që dotë marrë
Gjakn'e t'im'ati më parë.
Për mua, Mnsa, Selimi
Janë Skënder-beu trimi
I-dua të dy me besë
Sot, se ndë të dy kam shpresë
Sultani po të mos jetë
Njeri motrë dot'më ketë
Edhe tjetri po të rrojë
Më merr grua, po të dojë.
Më ndje për këtë guxim
Zot se të fola pa ndrim
Ndjemë ; kur kujtoj Sultanë..

SELIMI

Pusho ! ja ku na vjen pranë !

## Panj'e-III.

### Mamica, Selimi, Murati, Musa, Ushtarë

MURATI (te Mamica)

Zonjë me të kuvëndove.

Folë nga Selimi ç'msove !
E kandise të më dojë.

MAMICA

Nukë do të më ndëgjojë
Dhe nga fjalët që më tha
Duket s'të do për baba.
Se me mua ka një gjak.

MURATI

Shini mirë ; nga ky shkak
Ini të dy ndë rrezik.
Bir, pse bêne kaq'i-lik !
Bir, nga gjaku im ke dale
Mê ke baba, të kam djalë.
Ea sot ndë mênd Selim
Musa s'është djali im ;
Zëmra për ty më godit
S'e-ndëgjon si psherëtit
Të kam bir Selim, besome,
Ea tek un'e-pushtomë,
Ngjer sot me ty jam zbavitur
Me gas të math të kam rritur
Të kam dashur e të dua
Kemi një gjak e një sua
Me Sevdanë të kam bêrë
Si e-dinë bot'e-tërë
Mos e-beso Fatimenë,
Ajo që këmbeu fenë
Selim është gënjeshtare
Dhe besë nukë ka fare.
Ç'është'ajo mëmë ndë jetë
Që vret të bir'e saj vetë ?
S'gjëndet, bir, e-tillë grua.
Të të vijë keq për mua ;
Ndëgjo bir, Musa vezirë
Së të ka bërë të mirë
Mik me besë ka qëndruar
Nga vdekja të ka shpëtuar.

SELIMI

Ndaj dhe unë kam dëshirë
Të shpëtoj Musa vezirë ;
Dot'i-sillem si m'u suall.
Mbrët hap sytë se të duall
Kur s'nje Selimn'e vërtetë !

MURATI

Bir Selimi ti je vetë

SELIMI

Eshtë Musa, po shi mirë

MURATI

Selim për ty kam deshirë.

SELIMI

Mos u-gënje më të kottë

MURATI

O Selim, zëmra më thotë
Dhe zëmra kurrë s'gënjen...

SELIMI

Mua, zëmra më rrëfen
Që ti s' je baba për mua
Dhe për të tillë s'të dua.

MURATI

Selim të lutem, për besë
Lëmë të kem këtë shpresë
Lemë Selim, me një fjalë.
Të të marr të të bëj djalë
Të të fal sot gjithë gjënë.

SELIMI

Murat, mëndja të ka lënë:
Si dot'a bëj këtë punë!
Ti s'je m'i-mirë nga unë
Se sot me fuqi të Zotit
Jam i-bir'i Kastriotit
Nukë jam si ti barbar
Po jam thjeshtë Shqipëtar
Të lë sot një gjak fisnik
T'a këmbej me një të lik?
Të lë një baba dëshmor
Dhe të marr një gjakëtor
Q'ushqenet më të këqia?
Mos e-dhëntë Perëndia!
Shqipëtar jam, bres pas bres
Shqipëtar dua të vdes.

MURATI

Selim, të jeshë shpyrt-hekur
Tani do të keshe vdekur.
Ti do të vdeç të shpëtosh
Po unë dua të rrosh.
S'dua të humbas Selimnë
Se ja kupëtoj qëllimnë:
Ti ke sot këtë dëshirë
Se do të shpëtosh vezirrë
Q'është vëtet Skënder-beu
Se Fatimea s'gënjeu.
Musa sot duet të vdesë!
Që të mos kësh këtë shpresë
Dhe këtë mendim të lik
Të vritesh ti për një mik
(tek një nga ushtarët)
Që të mos humb, sot tim birrë
Tani këtu vre vezirë!
Të vrarë kur t'a shukojë
Do mos do dotë më dojë.

SELIMI (Ushtarit)

Qëndro ushtar mos e-nga!..

MUSA

Le Selim, të kam vëlla
Ç'punon?

SELIMI

Ndaloj nj egërrirë
Që do të vrasë të birrë!

MUSA

Mos Selim, mos e-ndalo

Ty të ka djal'e e ty do.
Fatimea të gënjeu
Se unë jam Skënder-beu.
Lemë të vdes sot me nder.

MURATI (Ushtarit)

Po ti ç'pret ? pse nuk'e ther .

SELIMI

Dale prit se kam një fjalë !
Murat, vërtet më ke.....

MURATI

Djalë !
Folë bir, ashtu më rruash.

SELIMI

Sot më ke... ç'do që të duash
Më do Selim ? Selim jam
Po mos vraç miknë që kam.
Kur do sot të më kesh djalë
Lemë vëllanë të gjallë.
Ja ku të them : besa besë
Vezir Musa po të vdesë
Gjakn'e-ti dot'a-kërkoj
Vetëm nga ti sa të rroj
Dhe im at të jesh vërtet...

MURATI

Bir të betonem si mbret
Të jap fjal'e të jap besë
Vezir Musa të mos vdesë.
Sido q'është Skënder-beu
(Se Fatimea s'gënjeu)
Kur ka miqësi me ty
Dot'u kem bashkë të dy
Si vëllezër dotë rroni
Pas meje të mbretëroni.
Selim, nukë di ç'të flas
Më mbushe shpyrtin me gas
Dhe Tani që të kam djalë
Dotë më ndëgjosh një fjalë
Sot s'besoj të më priç nderrë :
Nukë kam dhe djem të tjerë
Prandaj më ka marrë malli
Të sho një djalë nga djali ;
Ndaj dua sot të martonesh
Me Mamicën. të gëzonesh
Të gëzonem edhe unë.

SELIMI

Zot, nukë bënet kjo punë
Se Mamicën e-kam motrë
Jemi lindur ndë një vatrë
Ndaj hiq dorë nga qëllimi...

MURATI

S'the tani që je Selimi ?

MAMICA

Murat, Sultan i-pa- besë
Mos ecë me këtë shpresë :
Unë sot jam shqipëtare
Dhe nukë të peshoj fare

Mund të marr ç' burrë të dua
Po Selimi s'bën për mua ;
Selimi në të bën nder
Unë s'të dua për vjerr.
Pastaj more faqe-zi
Unë s'verbonem si ti ;
Ti thuaj të ka baba
Unë them q'e-kam vëlla !
Ti cinë panden të birrë
Selimn'a Musa vezirë .
Këtë s'e-dimë dot kurrë ;
Ndaj Selimnë s'e-marr burrë.

## Pamj'e-IV

**Feriti, Murati, Selimi, Mamica, Musa, Ushatrë**

FERITI (te Murati)

Trimat e-tu sot u-ngrenë
Dhe kërkojnë Skënder-benë.
Deshnë të vinë këtunë
Që t'-rrëmbejnë me dhunë !

MURATI

Po Tahiri, zëmër miri,
Ç'bën ?

FERITI

Eshtë me ta Tahiri !

MURATI

Tahiri ndë këtë punë ?

FERITI

Mos u-trëmb, të gjith'u-zunë
Rroft'e qoftë Muhameti
As një trim pa lidhur s'mbeti
U-lëshua me ushtarët
Për mbi trimat shqipëtarët
Një nga një të ter'i-zuri
Lidhur ndë pallas t'i pruri.

MURATI

Muhametit trim me pallë
Nga unë beni të falë ·
Armiqtë tani të tërë
Ndë një sallë lë t'i-vërë
Sa të vi atje. i-thuaj
Të rrijë vetë t'i-ruaj
Të shomë ç'kanë punuar
Mbronjesit e-mallëkuar.

(Feriti del)

## Pamj'e-V.

**Murati, Mamica, Selimi, Musa, Ushtarë**

MURATI

Ah ! të gjorët shqipëtarë
Nuk'u-vate puna mbarë !
I zunë të tër'i-zunë
Dhe këtu lidhur m'i-prunë.
Tani ng'armiqtë shpëtova.

(te Selimi)

Shumë, shumë të durova
Po ndëgjo tani Selim
S'kam frikë të flas pa ndrim
Nukë shtirem si më parë
Me të lutur, me të qarë
Do me thënë me një fjalë
Me pahir s'të dua djalë ;
Nukë je për këtë nder
Kur e pashke për kashmer.
Mendoju, mendoju mirë
Bashkë me Musa vezirë
Se Tani puna na pret.

(te MAMICA)

Ty, shpresë tjatër s'të mbet :
Ja merr Selimnë për burrë :
Ja që të dy s'i-she kurrë :
Njeri është djali im
Po s'mund të rri ndë dyshim ;
Cfnë nga këta të dua
Kur që të dy s'duan mua .
Ti në do të kesh vëlla
Xghidh e mer një nga këta
Në mos të dy dot'i-vras
Se s'mund të rroj me maras...
Porsa të ndërrojnë jetën
Dot'a-gjëjnë të vërtetën
Dose, dotë me shoç sot....

MAMICA

Murat nukë më trëmb dot
Se jam gati që të vdes
Me gas këtë dit'e-pres.

MURATI

Të vdeç ? mos ki këtë shpresë
Bënu gati për martesë.

MAMICA

Të martonem ?

MURATI

Sot k'shtu dua.

MAMICA

Me cin'o shtazë ?

MURATI

Me mua !
Kur t'i ther vëtë me dorë
Me ty do të vë kurorë.

MAMICA

Nukë bënet m'i math tmer

MURATI

Nukë bënet m'i math nder !
Jëshe fodulle për ditë
Tani të theva turitë....
Të bëra të më kesh frikë.

MAMICA

Nukë ke gjak as një çikë !...

MURATI

Tani thuaj si të duash,
Po ndëgjo ashtu më rruash :
Ti sot ja shpëton vëllanë
Ja martonej me Sultanë.
Mendoju për këtë punë
Sa të vi prapë këtunë. (del)

## Pamj'e-VI.

## MAMICA, SELIMI, MUSA

MAMICA

E patë tani Sultanë ?
Njerst'e-liq të tillë janë :
Sa ish vetë ndë rrezik
U-kuvëndonte si mik ;
Nga rreziku porsa dolli
Me gjuhë tjatër u-foli.
Njerst'e poshtër, si nga hera
Ven'e vinë nga fryn era.
Tani me fjalë të mira
Me lajka, me dhëlpërira
Kur i-egër, kur i-urtë
Kur i-keq e zëmër gurtë.
E patë këtë dragua ?
E ndëgjuat ç'tha për mua ?
E shukoni zëmër-guri
Ndë ç'rrezik të math më vuri ?
U-lutem sot të më ndini
Se të dy motër më kini.

MUSA (te Selimi)

Pse s'më le të vdes me nder
Të mos sho te tillë tmer ?

SELIMI

O Zot, pse më le të gjallë ?

MAMICA

Tani lini këto fjalë ;
Ndimëni, për krye tuaj
Se nukë jam bot'e-huaj

SELIMI

Ç'mund të bëjmë ? ç'mund të themi ?
Sot të dy për vdekij jemi !

MAMICA

Sot ndë një rrezik të tillë
Mos më lini pa këshillë.

MUSA

Ska këshillë më të mirë :
Të martonesh me të birrë
Që të shpëtosh nga babai.

MAMICA

Kush është sot im vëllai ?
Me fjalën e Fatimesë
Nukë di kujt'ti-vë besë.
Kush më tregon sot vëllanë ?

MUSA

Duet të quesh Sultanë
Martoju sot, merr një burrë
Dhe mos flini bashkë kurrë..

MAMICA

Pun'e-poshtër, jet'e-rrëme !
Sot.....

SELIMI

Këto janë llagëme –
Për Muratnë : kur të shojë
Q'e-ndëgjon dotë të dojë
Se ke të birr'e-ti burrë
Nukë do të trëmbet kurrë :
Kshtu dotë shomë Sultanë
Dhe dot'i qasemi pranë
Se dotë na vërë besë
Dhe një ditë kemi shpresë
T'a vrasim me një menyrë.

MAMICA

Vëllezër, sot kam detyrë
T'u-shpëtoj, të shpëtoj vetë
Nga një rrezik i-vërtetë
Dhe nga një tmer i-vështirë.
Ndaj kur e-gjëjni për mirë
Martesën gjëni të mbarë
Po nga-ju-kush do'më marrë ?

SELIMI

Ti vezir q'i-the më parë
Këtë mëndje, këtë fjalë.

MUSA

Ti se ty të do për djalë
Murati, mbret'i Turqisë.

SELIMI

Princesën e Shqipërisë
E- doje me këtë shpresë
Tani mos del i pa besë.

MUSA

Kjo të duantë më mirë
Dhe s'kishte tjatër dëshirë.

SELIMI

Më ka dashar për vëlla.

MUSA

Sot vëlla nukë të ka.

SELIMI

Sot jam vërtet Skënder-beu.

MUSA

Fatimea të gënjeu.

SELIMI

Lemë të vdes të mbyll synë ;
Mamica është për tynë.

MAMICA

Sa nukë dini se ç'ini
Që të dy motrë më kini,
Jni vëllezër për mua,
Ndaj s'më duani për grua.
Për një princ, për një princesë
Esht'e-ndyrë kjo martesë.
Që t'u denetis, u-qesha
Dhe bêra si-kur u-desha,
Po ini të dy me nder
Ndaj s'e-deshtë këtë tmer.
Tani të presim, të rrimë,
Zoti mbase na del ndime.

SELIMI

Ç'dotë shomë ? ç'dotë presim ?

MUSA

Sot që të dy dotë vdesïm !

MAMICA

Ju, në vdekshi sot shpëtoni,
Më të bukur fat kërkoni ?

SELIMI

Do të vdes pa ditur ç'jam.

MUSA

Dhe un'atë brêngë kam.

SELIMI

Zot, rrëfemë gjaknë t'im
Që të mos vdes ndë dyshim.

MUSA

Zot, rrëfemë ç'jam ndë ballë
Pastaj shpyrti le të dalë.

MAMICA

Vërtet ini për të qarë
Se u-bëjnë gati varrë
Po u- lutem të mos pshoni
Se ju vdisni dhe shpëtoni
Po qysh të bëj un'e mjera
Se paska ndjenja të tjera
Murati ? dojë të vdesë
Po s'më lë'as këtë shpresë
Po Tahiri ç'do këtunë ?

## Panj'e-VII.

**Mamica, Selimi, Musa, Tahiri, Trima**

TAHIRI

Murati s'është ndë jetë ?

MAMICA

Zot'i-math e i-vërtetë ?

SELIMI

Ç'thuaj kshtu ? kuvëndo mirë?

TAHIRI

Zot, u vra kjo egërsirë

Dhe sot me gjak të ti lau
Gjakn'e Janit.....

MUSA

Kush e vrau ?

TAHIRI

Zot, e vrau Mohameti
Nga dor'e keti vdiq mbreti ?

MUSA

Vanë mënd'e mia vanë
Vret vëllai të vëllanë !

SELIMI

Po qysh goditi kjo punë.
Ty Tahir nukë të zunë.
Gjithë trimat Shqipëtarë
Nuk'u lidhë me litarë

TAHIRI

Zot, kjo gënjeshtrë q'u-thanë,
Ishte dhokan për Sultanë.
Këtë fjal'e hapa unë
Që të mund të mbaroj punë :
Me trimatë Shqipëtarë
Ryta ndë pallas më parë
Dhe ahere Muhameti
Dërgoi lajmë te mbreti
Si-kur na lidhi të têrë,
Pas fjalës që kishim bêrë.
Gjithë me thikë ndë dorë
Pritnim Sultan gjakëtorë ;
Kur erdhi të na gjykojë
Mbeti me fjalë ndë gojë :
Muhameti nukë priti,
Me të pa bes'e-goditi
Dhe vrau vetë me dorë
Gjakëtori, gjakëtorë.

SELIMI

Po ç'e-bêre Fatimenë ?

TAHIRI

Zot, ja ku vjen me Zadenë.

**MAMICA, SELIMI, MUSA, TAHIRI, FATIMEA, ZADEA, TRIMA, SHQIPËTARË**

SELIMI (të Fatimea)

Zonjë, zonjë të jam falë,
Esht'e vërtetë kjo fjalë ?

FATIMEA

Zot, kjo fjal'ësht'e vërtetë :
Pashë me syt'e mi vetë
Muratnë kur ra ndë prak
Mbytyr i tërë ndë gjak !

MAMICA

Sa pa hipur Muhameti
T'ikim se shpëtim s'na mbeti :
Kur vrau vëllanë vetë
M'i-llk, m'i-keq dotë jetë ;
Nukë punoi për ne
Po vetëm për vetëhe.

FATIMEA

Mos u-trëmbni. me një fjalë
Muhameti s'ësht'i-gjallë.
E vrau vetë Tahiri
Rroft'e qoftë zëmër-miri.
Muhameti po të rronte
Kush e-di c'do na punonëte
Kur të zapëtonte fronë.

TAHIRI

S'di n'e-vrava, pasha Zonë,
Dy her'i rash'e lavosa
Po s'di në vdiq se s'e-sosa
Ulutem, u kërkoj ndjesë
Se dolla mik i-pa besë ;
E lash'e vrau Sultanë
Se na kishte vrarë Janë
Dhe pashë që kish dëshirë
T'i-vrasë sot dhe të birrë ;
Po s'i-keshë dhënë fjalë
Që t'a-lê pastaj të gjallë,
Me dhunë të mbretërojë
Dhe Selimnë t'a-ndalojë.

SELIMI

Rrofsh e qofsh nga Perëndia
Të gëzoftë Shqipëria !

MUSA

Sot të dy të ngjatjetojme
Dhe për mik të dëshërojimë.

SELIMI (te Musa)

Mik sot ish shkruar nga fati
Që të vritetë Murati ;
Të rrosh të mretërosh vetë
Se 'je Selim'i-vërtetë

MUSA

O mik ndjesë past'yt'atë
Nd'atë jetë ku ka vatë.
Ti në humbe sot babanë
Ke motrënë t'ime pranë
Merre mik, merre për grua
Të më kesh vëlla dhe mua.

(te MAMICA)

Në kish një baba të lik

Vet'është trim e besnik;
Motrë me të të martonesh
Në më do, të trashëgonesh.

MAMICA (të Fatimea)

Folë, zonjë të jam falë
Hapua sytë me një fjalë
Zot'i-math të ngjatë jetën
Rrëfena sot të vërtetën
Mbaroe sot këtë lodrë
Kush nga këta më ka motrë?
Se unë të dy i-dua.....

FATIME

Mbase s'më besoni mua.

MAMICA

Cinë tjatër të besojmë?
Zonjë, nga ti sot kerkojmë
Skënder-benë të vërtetë
Që shpëtove e rrite vetë.

FATIMEA

Mëm'e ti ndë varr,ndë kot
Mbase flet më mirë sot.
(i-ep një letrë Mamicës)
Merr tani këtë zotrote
M'a-ka lënë mëma jote
Merr'e këndo këtë kartë.

MAMICA

Eshtë dor'e-saj e-artë.
(Puth letrën)

SELIMI (te Zadea)

Cinë-do baba të kem
Yti jam e dote jem.

FATIMEA

Ndëgjoni se ç'thotë Sava
Ç'djalë fsheva, cinë vrava.

MAMICA (Kendon lëtrën)

« Hallet e brëngat e-mia
« Janë shumë të këqia
« Po dhe gazë t'im të plotë
« Nuk'e-ka tjatër ndë botë:
« Zonja Fatime besnike
« U-bë me Sultanë mike
« Dhe që t'a vërë ndë gjumë
« Shtiret sikur e-do shumë;
« Po Murati, kokë-shkretë
« E-deshi me të vërtetë
« Dhe t'i-rrëfejë gëzimnë
« J dha të rritij Selimnë.
« Këtu kjo një dit' polli

« Te mbreti me vrap e-solli
« Dhe tha me rrëmbim Sultanit
- Zot, ky ësht'i birr'i Janit
Që vuadh dy Shqipëtarë
Tani ka ca dit më parë.
Zot, ky është Skënder beu
Duet t'a mbulojë dheu
Që të shuetë kjo barë
Se Jani, zot më ka vrarë
T'im shoq, një trim të vërtetë
« Ahere murati vetë
« Më këto fjal'u gënjye
« Nga inati u rrëmbye
« Dhe mori theri jetimnë !
« Im bir u rrit për Selimnë
« Dhe sot Selim'i vërtetë !
« Nuk është ndë këtë jetë.
« Ndaj sot me fuqi të Zotit
« Rron i bir'i Kastriotit.
« Ndë krah të djathtë ky djalë
« Ka një shënjë si një pallë.»

«Sava»

SELIMI (hap kranë)

Skënder-beu qënkam unë
Ja shënja që kam këtunë !

MAMICA (me gas)

Vëlla ti je Skënder-beu
Fatimea s'na gënjeu.

MUSA (te Fatimea)

Zonjë, po unë sot c'jam ?

FATIMEA

Im, bir, se pjellë të kam
Të kam dashur e të dua.

MUSA

Po sot pse qeshe më mua ?
Pse sot me letrën që shkrove
Për Skënder-be më tregove ?

FATIMEA

Që t'a shpëtoj nga rreziku

SELIMI (te Mamica)

Qasu moj motrë te miku
Se s' gjën si Musa vezirë
Burrë tjatër më të mirë
(te Zadea)
Zonjë, në do këtë dorë
Eshtë jotja me kurorë.
Të kam dashur e-të dua
Se ti je grua për mua.
(te Fatimea).
Me punëra që ke bërë

Të kemi mêmë të têrë.

(te Tahiri).

Dhe ty,o trim Shqipëtar,
Me mua do të të marr,

(te trimatë).

Dhe ju trima Shqipëtarë
Eni me mua ushtarë
Të lëftojmë më Turqinë,
Të shpëtojmë Shqipërrinë.

GJITHË TOK.

Skënder-beu, rroft'e qoftë!
Ndë Shqipëri mbretëroftë!

FUND

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH